Kumbona e së Diellës



KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT

Nr.3/4, Mars - Prill 2012

A KA PËRPLASJE MES BIBLËS DHE SHKENCËS?!

Si e përshkruanin Shumerët krijimin e njeriut!

(Pjesë nga libri, Planeti i 12- të)

- Pjesa 6 -

Autori, shprehet se:
"libri në fjalë, nuk ka asnjë kundërshtim midis Biblës dhe Evolucionit.
"Libri i qëndron kohës", thotë autori, dhe "besoj unë, se na tregon të vërtetën për vet zanafillën tonë- dhe që,
NE NUK JEMI VETEM."

ZECHARIA SITCHIN
Planeti i 12 -të
Tiranë, 2009.

S'mund të kërkojmë përshkrim më të mirë të njeriu-majmun: me flokë të gjata, leshtor, një endacak e bredharak që "nuk njeh as njerëzit as vendin,"veshur me gjethe, "si një i fushave të blerta," që ushqehet me bar, dhe jeton mes kafshëve. Prapë ai në thelb s'është pa zgjuarsi, se e di t'i shkrehë çarqet e t'i mbushë gropat e gërmuara për të kapur kafshët. Me fjale te tjera, ai i mbronte shokët e vet kafshe nga kapja prej gjahtarëve të huaj. Kanë qenë gjetur shumë vula cilindrike që e paraqesin këtë njeri-majmun leshtor mes shokëve te tij kafshë.

Pasi përballur me nevojën për fuqi punëtore, vendosen të përfitojnë një Punëtore te Ulet. Nefelimet pan enje zgjidhje të gatshme te zbusnin një kafshe te përshtatshme.

"Kafsha"gjendej- por *Homo crektusi*, shtronte një problem. Nga njëra ane, ai ishte tepër i zgjuar e i egër qe te behej thjesht një kafshë e bute pune. Nga ana tjetër, nuk qe vërtet i përshtatshëm për pune. Fiziku i tij duhej ndryshuar- duhet të qe i afte t'i kapte dhe përdorte veglat e Nefilimeve, të ecte e përkulej si ata që kështu të mund t'i zëvendësonte zotat në fushat e në e në minierat. Ai duhet t'i kish "trutë" më të mire- jo si ata të zotave por mjaft për te kuptuar te folurën e urdhrat dhe detyrat që i caktoheshin. Atij i duhej zgjuarsi dhe te kuptuarit e mjaftueshëm sa për te qenë një "amelu" i bindur e i dobishëm- një bujkrob.

Nëse, siç duket ta mbështesin dëshmitë e lashta dhe shkenca moderne, jeta ne Tokë nga jeta në Planetin e Dymbëdhjetë, atëherë evolucioni ne Toke duhet te ketë vazhduar si ne Planetin e Dymbëdhjetë. Padyshim kish shformime gjenetike, ndryshime, përshpejtime, e ngadalësime shkaktuara nga kushtet ndryshme vendore; por te njëjta kode gjenetike, e njëjta "kimi e jetës" gjetur në tere bimët dhe kafshët e gjalla ne Tokë, duhet gjithashtu ta kish drejtuar zhvillimin e formave te jetës në Tokë në të njëjtin drejtim të përgjithshëm si në Planetin e Dymbëdhjetë.

Duke i vëzhguar format e larmishme të jetës në Toke, Nefilimeve dhe kryeshkencetarët të tyre, Ea-s, iu desh pak kohe për ta kuptuar ç'kish ndodhur: Gjate përplasjes qiellore, planeti i tyre e kish mbjelle Token me jetën e tij. Prandaj, qenia që mund të përdorej ish vërtet e afërt me Nefilimet- megjithëse në një forme më pak të evoluar.



Papa Benedikti XVI
GËZOHUNI GJITHMONË ME ZOTIN 4

Bijat e Zellit Hyjnor
DËRGO O ZOT APOSTUJ 8

Loreta Tomaj
NJERIU KJO QËNIE E MISTERSHME 11

Simoneta Fenu
KJARA GRUA NËNË E MËSUESE 13

Dom Pren Kola
KAMBANA NË HISTORI 16

Dom Lush Gjergji
GJERGJ FISHTA DHE ARSIMIMI 19

Prof. Tomor Osmani
DODË KOLECI DHE GRAMATIKA SHQIP 20

Ndue Dedaj
MONUMENTET PEZULL 25

Dom Nikë Ukgjini
RREGJIMI KOMUNIST MBYLLI KISHAT 27

Mentor Quku
BIOGRAFI PËR POETIN MJEDA 29

BUSTI I FISHTËS NE JAGODË 31

VITRINA E LIBRIT

KUMBONA E SË DIELLËS

Viti XXVII, nr. 3/4 (438-439) Mars - Prill 2012

Revistë
Fetaro-Kulturore
Drejtues
***Imzot* Angelo MASSAFRA**

Redaksia
Dom Nikë Ukgjini (Kryeredaktor)
Atë Mario Imperatori S.I.
Dom Gjovalin Sukaj
Loreta Tomaj

Adresa:
Arqipeshkvia Shkodër
Sheshi Gjon Pali II
Tel. 0222-42764
Fax. 0222-43673
e-mail: n_ukgjini@yahoo.it
Web page: kishakatolikeshkoder.com

Redaktor teknik: Xhon NIKA

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT

GËZOHUNI GJITHMONË NË ZOTIN

Mesazhi i Papa Benediktit XVI
për ditën botërore të rinisë
Vatikan, 15 mars 2012

(Pjesa e parë)

Të dashur të rinj,

me gëzim ju drejtohem sërish juve, me rastin e Ditës XXVII Botërore të Rinisë. Kujtimi i takimit të Madridit, vitin e kaluar, vazhdon të jetë i gjallë në zemrën time. Qe një çast i jashtëzakonshëm hiri, gjatë të cilit Zoti i bekoi të rinjtë e pranishëm, të ardhur nga e gjithë bota. E falënderoj Hyjin për frytet e shumta që bëri të lindin në ato ditë dhe që në të ardhmen do të vazhdojnë të shumohen për të rinjtë dhe bashkësitë të cilave ata u përkasin. Tashmë jemi të drejtuar kah takimi i ardhshëm në Rio de Janeiro në vitin 2013, që do të ketë temën: "Shkoni e bëni dishepuj të gjithë popujt!" (khs *Mt* 28,19).

Këtë vit, tema e Ditës Botërore të rinisë na jepet nga një thirrje e Letrës së Shën Palit apostull drejtuar Filipineve: *"Gëzohuni gjithmonë në Zotin!" (Fil 4,4). Gëzimi, në fakt, është elementi qendror i përvojës së krishterë. Edhe gjatë çdo Dite Botërore të Rinisë ne jetojmë përvojën e një gëzimi intensiv, gëzimin e bashkimit, bashkimin e të qenit të krishterë, gëzimin e besimit. Është kjo një nga karakteristikat e këtyre takimeve. Dhe shohim forcën e madhe tërheqëse që ka: në një botë të shënjuar shpesh nga trishtimi dhe shqetësimet, është një dëshmi e rëndësishme e bukurisë dhe besueshmërisë së besimit të krishterë.*

Thirrja e Kishës është që t'i sjellë botës gëzimin, një gëzim të mirëfilltë dhe të qëndrueshëm, të njëjtin gëzim që engjëjt ia kanë lajmëruar barinjve në Betlehem natën e lindjes së Jezusit (khs *Lk* 2,10):

Hyji, jo vetëm ka folur, jo vetëm ka kryer shenja të mrekullueshme në historinë e njerëzimit, Hyji ka ardhur aq pranë nesh saqë u



bë njëri nga ne dhe i përshkoi të gjitha fazat e jetës së njeriut. Në kontekstin e vështirë të sotëm, shumë të rinj përreth jush kanë një nevojë të pamasë për të dëgjuar se mesazhi i krishterë është një mesazh gëzimi dhe shprese! Pra do të doja të reflektoja së bashku me ju për këtë gëzim, për rrugët si mund të gjehet, që të mund ta jetoni gjithnjë e më thellësisht dhe të jeni lajmëtarë të tij mes atyre që ju rrethojnë.

Zemra jonë është krijuar për gëzimin!

Prirja kah gëzimi është e skalitur në thellësinë e qenies njerëzore. Përtej kënaqësive të menjëhershme dhe kalimtare, zemra jonë kërkon gëzimin e thellë, të plotë dhe të qëndrueshëm, që mund t'i japë "shije" ekzistencës. Dhe kjo vlen sidomos për ju, sepse rinia është një periudhë e zbulimit të vazhdueshëm të jetës, të botës, të të tjerëve dhe të vetvetes. Është një kohë e çeljes drejt të ardhmes, në të cilën shfaqen dëshirat e mëdha të lumturisë, të miqësisë, të bashkëndarjes dhe të së vërtetës, në të cilën nxitemi nga idealet dhe ndërtojmë projekte.

Dhe çdo ditë janë të shumta gëzimet e thjeshta që Zoti na ofron: gëzimi i jetës, gëzimi përballë bukurisë së natyrës, gëzimi i një pune të bërë mirë, gëzimi i të shërbyerit, gëzimi i dashurisë së sinqertë dhe të pastër. Dhe, nëse shohim me kujdes, ka shumë arsye të tjera gëzimi: çastet e bukura të jetës familjare, miqësia e bashkëndarë, zbulimi i aftësisë personale dhe arritja e rezultateve të mira, vlerësimi i të tjerëve, mundësia për t'u shprehur dhe për t'u ndjerë të kuptuar, ndjesia e të qenit të dobishëm për të afërmin. Dhe më pas fitimi i njohurive të reja përmes studimeve, zbulimi i përmasave të reja përmes udhëtimeve e takimeve, mundësia për të bërë projekte për të ardhmen. Por edhe përvoja e leximit të një vepre letrare, e admirimit të një kryevepre arti, e dëgjimit apo luajtjes së muzikës apo shikimit të një filmi mund të shkaktojnë në ne gëzim të vërtetë e të mirëfilltë.

Por, ama, çdo ditë përballemi edhe me shumë vështirësi dhe në zemër kemi shqetësime për të ardhmen, aq sa mund të pyesim veten nëse gëzimi i plotë dhe i qëndrueshëm kah i cili priremi është një iluzion dhe një arratisje nga realiteti. Janë të shumtë të rinjtë që i bëjnë pyetje vetes: a është vërtet i mundur gëzimi i plotë në ditët e sotme? Dhe ky kërkim përshkon rrugë të ndryshme, disa prej të cilave zbulohen si të gabuara, ose të rrezikshme. Por si t'i dallojmë gëzimet vërtet të qëndrueshme nga kënaqësitë e çastit e mashtruese? Si ta gjejmë gëzimin e vërtetë të jetës, atë që zgjat dhe nuk na braktis edhe në çastet e vështira?

Hyji është burimi i gëzimit të vërtetë!

Në të vërtetë, gëzimet e mirëfillta, gëzimet e vogla të përditshmërisë dhe të mëdhatë e jetës, e gjejnë të gjitha zanafillën tek Hyji, edhe pse nuk duket në shikim të parë, sepse Hyji është bashkim i dashurisë së amshuar, është gëzim i pafund që nuk mbetet i mbyllur në vetvete, por përhapet tek ata që Ai i do dhe që e duan. Hyji na ka krijuar sipas shëmbëllimit të vet për dashuri dhe për të na dhënë neve dashurinë e vet, për të na mbushur me praninë e vet dhe me hirin e vet. Hyji do të na bëjë pjesëmarrës të gëzimit të vet, hyjnor dhe të amshuar, duke na bërë të zbulojmë se vlera dhe kuptimi i thellë i jetës sonë qëndron në të qenët i mirëpritur, i pranuar, i dashur nga Ai, dhe jo me një pranim të brishtë, siç mund të jetë pranimi njerëzor, por me një pranim të pakushtëzuar siç është ai hyjnor: mua më duan, unë kam një vend timin në botë dhe në histori, Hyji më do personalisht. Dhe, nëse Hyji më pranon, më do dhe unë jam i sigurt, e di në mënyrë të qartë dhe të sigurt se është gjë e mirë që unë jam, që ekzistoj.

Kjo dashuri e pafund e Hyjit për secilin prej nesh shfaqet në mënyrë të plotë në Jezu Krishtin. Tek Ai gjendet gëzimi që kërkojmë. Në Ungjill shohim sesi ngjarjet që shënjojnë fillimet e jetës së Jezusit karakterizohen nga gëzimi. Kur kryeengjëlli Gabriel e lajmëron Virgjërën Mari se do jetë nëna e Shpëtimtarit, e nis me këto fjalë: "Gëzohu!" (khs *Lk* 1,28). Si lind Jezusi, Engjëlli i Zotit u thotë barinjve: "Ja, unë po ju sjell një lajm të mirë: gëzim të madh për



mbarë popullin! Sot, në qytet të Davidit, ju lindi Shëlbuesi – Krishti Zot!" (*Lk* 2,11). Dhe Dijetarët që kërkonin fëmijën, "kur e panë yllin, u bënë shend e verë" (*Mt* 2,10). Arsyeja e këtij gëzimi është, pra, afërsia e Hyjit që është bërë njëri prej nesh. Dhe këtë kishte ndër mend Shën Pali kur u shkruante të krishterëve të Filipit: "Gëzohuni gjithmonë në Zotin, rishtas po ju them: gëzohuni! Mirësinë tuaj le ta njohin të gjithë njerëzit! Zoti është ngjat!" (*Fil* 4,4-5). Shkaku i parë i gëzimit tonë është afërsia e Zotit, që më pranon dhe më do.

Dhe në fakt nga takimi me Jezusin lind gjithnjë një gëzim i madh i brendshëm. Në Ungjij mund ta shohim këtë në episode të shumta. Le ta kujtojmë sërish vizitën e Jezusit tek Zakeu, një tagrambledhës i pandershëm, të cilit Jezusi i thotë: "Sot do të vij të rri në shtëpinë tënde". Dhe Zakeu, siç na thotë shën Luka, "e pranoi plot gëzim" (*Lk* 19,5-6). Është gëzimi i takimit me Zotin; është të ndjerët e dashurisë së Hyjit që mund ta shndërrojë krejt ekzistencën dhe të sjellë shpëtim. Dhe Zakeu vendos të ndryshojë jetën dhe të japë gjysmën e pasurisë së tij për të varfëritë.

Në çastin e mundimit të Jezusit, kjo dashuri shfaqet me gjithë fuqinë e saj. Në çastet e fundit të jetës së tij tokësore, gjatë darkës me miqtë e tij, Ai thotë: "Sikurse Ati më ka dashur mua, ashtu edhe unë ju kam dashur ju. Qëndroni në dashurinë time... Ju thashë këto, që gëzimi im të jetë në ju e gëzimi juaj të jetë i plotë" (*Gjn* 15,9.11). Jezusi dëshiron të fusë dishepujt e vet dhe secilin prej nesh në gëzimin e plotë, në gëzimin që ai bashkëndan me Atin, që dashuria me të cilën Ati e do të jetë në ne (khs. *Gjn* 17,26). Gëzimi i krishterë është të çelemi ndaj kësaj dashurie të Hyjit dhe t'i përkasim Atij.

Tregojnë Ungjijtë se Maria e Magdalës dhe gra të tjera shkuan për të vizituar varrin ku e kishin vendosur Jezusin pas vdekjes së tij dhe një Engjëll u dha një lajm tronditës, lajmin e ringjalljes së tij. Atëherë, ato e braktisën me ngut varrin, dhe Ungjilltari na thotë "me frikë e njëherësh me gëzim të madh", dhe vrapuan për t'u dhënë lajmin e mirë nxënësve të tij. Jezusi u

doli atyre përpara dhe tha: "Ju falem!" (*Mt* 28,8-9). Atyre u ofrohet gëzimi i shpëtimit: Krishti është i gjalli, është Ai që ka mposhtur të keqen, mëkatin dhe vdekjen. Ai është i pranishëm në mes nesh si i Ringjalluri, deri në fundin e botës (khs *Mt* 28,20). Nuk e ka e keqja fjalën e fundit mbi jetën tonë, por besimi në Krishtin shpëtimtar na thotë se dashuria e Hyjit është fitimtare.Ky gëzim i thellë është fryt i Shpirtit Shenjt që na bën bij të Hyjit, të aftë për të jetuar dhe për të shijuar mirësinë e tij, për t'iu drejtuar atij me fjalën "Abbà", Atë (khs *Rom* 8,15). Gëzimi është shenja e pranisë së tij dhe e veprimit të tij në ne.

Ta ruajmë në zemër gëzimin e krishterë!

Në këtë pikë pyesim veten: si ta marrim dhe ta ruajmë këtë dhuratë të gëzimit të thellë, të gëzimit shpirtëror?

Një Psalm na thotë: "Vëre gëzimin tënd në Zotin e ai do t'i plotësojë dëshirat e zemrës sate" (Ps 37,4). Dhe Jezusi shpjegon se "mbretëria e qiellit është e ngjashme me visarin e fshehur në arë: njeriu që e gjen, e fsheh prapë, dhe, plot gëzim, shkon, shet gjithçka ka dhe e blen atë arë" (*Mt* 13,44). Gjetja dhe ruajtja e gëzimit shpirtëror lind nga takimi me Zotin, që të kërkon ta ndjekësh, të bësh një zgjedhje me vendosmëri dhe gjithçka ta luash për Të. Të dashur të rinj, mos kini frikë ta vini jetën tuaj në lojë duke i bërë vend Jezu Krishtit dhe Ungjillit të Tij; është rruga për të arritur paqen dhe lumturinë e vërtetë në thellësi të vetes sonë, është rruga për realizimin e vërtetë të ekzistencës sonë si bij të Hyjit, të krijuar në përngjasimin dhe shëmbëllimin e tij.

Të kërkojmë gëzimin në Zotin: gëzimi është fryti i besimit, është të njohim çdo ditë praninë e tij, miqësinë e tij: "Zoti është ngjat!" (*Fil* 4,5); është ta vendosim besimin tonë tek Ai, është të rritemi në njohjen dhe dashurinë e Tij. "Viti i besimit", që do e fillojmë pas disa muajsh, do të na ndihmojë e do të na nxisë. Të dashur miq, mësoni të shihni se si Hyji vepron në jetët tuaja, zbulojeni të fshehur në zemrën e ngjarjeve të përditshmërisë suaj. Besoni se ai është gjithnjë besnik ndaj besëlidhjes që ka lidhur me ju ditën e Pagëzimit tuaj. Ta dini se nuk do ju braktisë kurrë. Drejtojeni shpesh shikimin tuaj kah Ai. Mbi kryq ka dhënë veten e vet sepse ju do. Kundrimi i një dashurie kaq të madhe sjell në zemrat tona një shpresë dhe një gëzim që asgjë nuk mund t'i mposhtë. Një i krishterë nuk mund të jetë kurrë i trishtuar sepse ka takuar Krishtin, që ka dhënë jetën për të.

Ta kërkojmë Zotin, ta takojmë në jetën tonë do të thotë edhe të pranojmë Fjalën e tij, që është gëzim për zemrën. Profeti Jeremi shkruan: "Kur më erdhën fjalët e tua, i përpija, fjala jote për mua u bë gëzim e hare e zemrës sime" (*Jer* 15,16). Mësoni ta lexoni dhe ta përsiasni Shkrimin e Shenjtë, do të gjeni aty një përgjigje për pyetjet më të thella të së vërtetës që banojnë në zemrën tuaj dhe në mendjen tuaj. Fjala e Hyjit na bën të zbulojmë mrekullitë që Hyji ka kryer në historinë e njeriut dhe, plot me gëzim, na çel kah lavdërimi dhe adhurimi: "Ejani t'i këndojmë Zotit…ta adhurojmë, të biem në gjunjë para Zotit që na krijoi" (*Ps* 95,1.6).

Liturgjia është, në mënyrë të veçantë, vendi më i shkëlqyer ku shprehet gëzimi që Kisha e merr nga Zoti dhe ia përcjell botës. Çdo të diel, në Eukaristi, bashkësitë e krishtera kremtojnë Misterin qendror të Shpëtimit: vdekjen dhe ngjalljen e Krishtit. Është ky një çast themelor për ecjen e çdo dishepulli të Zotit, ku bëhet i pranishëm Flijimi i tij i dashurisë; është dita në të cilën takojmë Krishtin e Ringjallur, dëgjojmë Fjalën e tij, ushqehemi me Trupin e tij dhe me Gjakun e tij.
Një Psalm pohon: "Kjo është dita që na e dhuroi Zoti të galdojmë e të gëzojmë në të!" (*Ps* 118,24). Dhe natën e Pashkës, Kisha këndon Exultet, shprehje gëzimi për fitoren e Jezu Krishtit mbi mëkatin dhe mbi vdekjen: "Le të ngazëllejë kori i engjëjve… Të gëzojë toka e përfshirë nga një shkëlqim i tillë… dhe i gjithi ky tempull të kumbojë nga brohoritjet e popullit që feston!". Gëzimi i krishterë lind kur e dimë se na do një Hyj që është bërë njeri, ka dhënë jetën e vet për ne dhe ka mposhtur të keqen dhe vdekjen; dhe të jetosh prej dashurisë për të. Shenjta Terezë e Jezusit Fëmijë, karmelitane e re, shkruante: "Jezus, gëzimi im është të të dua ty!" (P 45, 21 janar 1897, Op. Compl., f. 708).

DËRGO O ZOT, APOSTUJ TË SHENJTË NË KISHËN TËNDE!
Annibale, rinin e kalonte në lutje !

Një mision në Zemrën e Hyjit

Ç'do njeri vjen në këtë botë për të realizuar një thirrje, për të kryer një mision që Zoti i'a ka caktuar. Ashtu edhe ç'do Kongregatë Rregulltare duhet të realizojë atë mision të veçantë për të cilin Hyji e ka thirrur. E cili është ky mision i veçantë në Zemrën e Hyjit për Kongregatën e Bijave të Zellit Hyjnor? Ja si e shpreh këtë Themeluesi ynë Shën Annibale Maria Di Francia, në shkrimet e tij.

" Bijë, depërto në Kraharorin shumë të Shenjtë të Jezusit, jeto brenda kësaj Zemre Hyjnore, ndieje dashurinë e tij e bëji tuat të gjitha interesat e tij, merr pjesë në sakrificën e tij; ngushëllo këtë Zemër Hyjnore me shenjtërimin tënd dhe me përfitimin e shpirtërave, veçanërisht me bindjen e atij Urdhëri të Zemrës së Jezusit kur tha: E korra është e shumtë, por punëtorë janë pak. Luteni pra të Zotin e të korrave që të dërgojë punëtorë në të korrat e veta. Gjithçka do të bësh sipas shembullit të Martës e Marisë, domethënë të jetës së brendshme dhe jetës aktive."

125- vjet histori nuk janë shumë, por nuk janë as pak, për t'a shprehur më së miri këtë mision. Janë 125- vjet dhuratë e pranuar me mirënjohje dhe e jetuar me angazhim e besnikëri, nga gjitha ato bashkëmotra që i janë besuar Zotit në kërkim të fytyrës së Tij, duke shprehur kështu ëmbëlsinë e butësinë e dashurisë së Tij të mëshirshme, ndaj të vegjëlve e të varfërve. Por ajo më e rëndësishmja që duhet të theksohet është, se vetë Hyji 125- vjet më parë, filloi një tjetër "histori të shenjtë", duke bërë besëlidhje me Bijat e Zellit Hyjnor.

Po kush ishte Shën Annibale?

Lindi në Mesina-Itali, me 5 korrik të vitit 1851, i treti ndër katër fëmijë, nga një familje fisnike. Babai i tij Françesk Di Francia, ishte markez i Shën Katerinës, i dekoruar nga Papa Piu IX me titullin "Zëvendës i Konsullit Papnor dhe kapiten nderi i marinës". Nëna e tij quhej Ana Toskano edhe ajo vinte nga një familje fisnike. Vështërsitë fillojnë menjëherë që në moshë të njomë në jetën e Annibalit të vogël. Akoma nuk ka mbushur dy vjet kur i vdes babai. Nëna merr vendimin e dhimbshëm që t'ia lë në besim djalin një tezeje të moshuar: dhe kështu Annibale jeton si një jetim në një mënyrë akoma dhe më të dhimbshme e tronditëse.

Për një fëmijë këto përvoja ishin plagë djegëse,



por Provania nuk lejoi që plagët t'ia ngurtësonin zemrën, por t'a hapnin në një dashuri akoma më të madhe, më bujare e të palodhshme. Kthehet të jetojë përsëri në familje me nënën e vëllezërit e tij. I nxitur nga shembulli i nënës e cila jetonte një jetë me të vërtetë të krishterë, Annibale që në rininë e tij kalonte shumë kohë në lutje. Ushqen kështu një dashuri të madhe për Jezusin Eukaristi, e pikërisht aty nën këmbët e Jezusit do të zbulojë thirrjen e tij e do të fillojë aventurën e tij të shenjtërisë. Ndërsa lutej para Jezusit në Sakrament, para se të lexonte akoma në Ungjill urdhrin hyjnor të «Rogate ergo-Lutuni pra», kuptoi që lutja për të kërkuar dhuratën e thirrjeve meshtarake, sigurisht është një vullnet i Hyjit. Annibale vuri re, me vuajtje të pashprehshme, që: *«bëhen lutje për shiun, për korrje të mira... dhe për njëqind arsye të tjera njerëzore por lihet pas dore që të lutet Hyji që të dërgojë punëtorë të mirë ungjillorë».*

Kur lexoi në Ungjill, për herë të parë, fjalët: *«Lutuni, pra, Zotërisë së të korrave të dërgojë punëtorë në të korrat e veta» (Mt 9,38 ; Lk 10,2)* iu duk që i njihte prej kohësh: Zoti i'a kishte shkruar në zemër

nëpërmjet një sintonie me Zemrën e Tij. Me surprizën e atij që më së fundi ka gjetur çka prej kohësh kërkonte, ai do të thotë:

«Ajo Fjalë e Krishtit, "Lutuni" është një urdhër i Zellit të Zemrës së Tij Hyjnore, urdhër i një rëndësie shumë të madhe dhe lutje së bashku. Është një detyrë e çdo të krishteri që t'i bindet këtij urdhëri».

«Rogate», ndërkaq, bëhet gjithmonë e më shumë karakteristikë e veprës së Atë Annibales: është, siç thuhet sot, «*urdhëri*» i tij. «*Lutja për thirrjet*» bën një gjë të vetme me të: është ajo që shpjegon mundin e tij, qëndresën e tij, jetën e tij. Ai e kupton dramaticitetin dhe hidhërimin e pohimit të Jezusit: «*Të korrat janë të mëdha, por punëtorë ka pak. Lutuni, pra*» «Lutuni, pra...» vuloset në shpirtin e Atë Annibales, bëhet dritë për hapat e tij, yll për mendjen e tij.

Të veprosh në vreshtin e Zotit, në Kishë, për Atë Annibalen do të thoshte, para së gjithash, të vihej në shërbim të bariut të tij, Papës, Zëvendësit të Krishtit, që dëshironte ta quante «rojtari më i lartë i Nuses së tij mistike, timonier qiellor i anijëzes së Pjetrit». Përpjekjet e tij filluan të japin rezultatet e para. Papa Leoni i XIII i dha kurajo që të vazhdonte punën derisa t'a realizonte plotësisht. Shën Piu X e mbështeti me bekimet e veta, duke vënë në dukje se kishte gjetur mënyrën "për t'i bërë jehonë urdhërit të Krishtit". Benedikti i XV e shpalli veten "Rogacionist" të parë. Piu XI kur e aprovoi " Bashkimin e Lutjes për Thirrje " e përcaktoi: "vepra e veprave". Papa Pali i VI në vitin 1964 ka themeluar "Ditën Botërore të lutjes për thirrje" e me këtë kurorëzohet me sukses dëshira apostolike që e ndezi flakë gjatë gjithë jetës së tij Atë Annibalen. Kështu sot mbarë Kisha deri në skajet e botës thërret "Rogate- Lutuni"duke bërë realitet ëndrren e Atë Annibales. Papa Gjon Pali i II, me 07 tetor të vitit 1990 e shpall të Lum, Atë Annibalen, duke e quajtur, «*Paraprirës i vërtetë dhe mësues i zellshëm i pastoralit modern të thirrjes*» dhe me 16 maj të vitit 2004 ia paraqet mbarë kishës si model imitimi, duke e shpallur Shenjt.

Fjala e Ungjillit*: "Rogate ergo Dominum Messis ut mittat Operarios in Messem suam,"* shqetësonte pandërprerë mendimet e mia, që nga fillimi i kësaj Vepre të Përshpirtshme. Duhej të reflektohej: Çfarë janë këta pak të varfër që ungjillëzohen, para milionash të tjerë që humbasin dhe gjenden të braktisur sikur delet pa Bari? Merrja parasysh përkufizimin e forcave të mia të mjera dhe aftësinë time shumë të vogël, dhe kërkova një rrugëdalje dhe e gjeta të gjerë, të pafundme në ato fjalë të adhurueshme të Zotit Tonë Jezu Krishtit. «*Rogate ergo Dominum Mesis ut mittat Operarios in Messem suam*». Atëherë m'u duk se e gjeta sekretin e të gjitha Veprave të mira dhe të shpëtimit të të gjitha shpirtrave.

Për Atë Anibalen ishte tepër pak, "një vepër jo komplete" siç e quan ai: të ushqesh të varfërit e të mos i ungjillëzosh. Prandaj mund ta kuptojmë më së miri Zellin me të cilin i ushqeu të varfëritë e jetimët e tij, për atë fjalë të mrekullueshme ungjillore "Rogate ergo",kështu ata bëhen të parët bashkëpunëtorë të Atë Annibales në "lutjen për thirrje". Pasi i përgatiti për dy vjet rresht djemtë e vajzat e jetimoreve të tij e banorët e lagjes Avinjone vendos për herë të parë, Jezusin në të Shenjtërueshmin Sakrament në Kishëzën e tij ku tashmë do të banojë përgjithmonë në veprat e tij Është pikërisht data 1 korrik e vitit 1886. Kjo datë do të mbetet e paharrueshme në historinë e dy familjeve rregulltare që më pas do të themelojë e do të përkujtohet çdo vit në lutje adhurim e falenderim, si dita në të cilën, Jezusi ka ardhur të banojë përgjithmonë në mesin tonë në të Shenjtërueshmin Sakrament.

Lulet e para

Ndërkaq, i bindur se i vetëm nuk do të mund të dilte t'u vinte në ndihmë nevojave të panumërta të jetimoreve të tij, mendon e kërkon t'ua besojë ato kongregatave që ishin atëherë në Messina por pa rezultate. Pas shumë refuzimesh e përpjekjesh të dështuara bindet e i dorëzohet plotësisht vullnetit të Hyjit. Me dt.18 Mars 1887 në vigjiljen e festës së Shën Jozefit, nën mbrojtjen e të cilit vë edhe Kongregatën e tij, u jep veshjen rregulltare katër vajzave të para. Kjo ngjarje shënon fillimin, lindjen e Familjes së Bijave të Zellit Hyjnor. Mund t'a konsiderojmë këtë ngjarje si fryt i parë i pranisë së përhershme të Jezusit në Sakrament e si fryt i lutjes së jetimëve e të të varfërve të tij.

«Krejt qendra e dashurisë, e detyrës dhe e vazhdueshmërisë së kësaj Vepre Përshpirtërie e Interesave të Zemrës së Jezusit, duhet të jetë Jezusi në Sakrament. Duhet të dihet dhe të mbahet, tani dhe përgjithmonë, që kjo Vepër Përshpirtërie ka pasur themelues të vërtetë të tij, të vlefshëm dhe të drejtpërdrejtë Jezusin në Sakrament»

E shkruan akoma : *"Qoftë Jezusi në Sakrament për të gjitha Bijat e Zellit Hyjnor si zgjoja e bletëve, rreth së cilës sillen e risillen, e brenda së cilës pushojnë e formojnë mjaltin e ëmbël të atyre virtyteve, që më shumë i pëlqejnë Zemrës së tij të Shenjtë".*

Karizma jonë është inteligjenca e zelli i fjalëve

të Jezusit: "Lutuni pra Zotit të të korrave..."bindja ndaj këtij urdhëri na karakterizon në kishë si Bija të Zellit Hyjnor. Prandaj është për ne edhe kushti i katërt ,nën dritën e të cilit jetojmë këshillat ungjillore të pastërtisë, varfërisë e bindjes. Karizma jonë na angazhon: të lutemi që Zoti të dërgojë punëtorë të Ungjillit, t'a përhapim kudo shpirtin e kësaj lutjeje e të jemi ne ata punëtorë të shenjtë.

Instituti ynë i është kushtuar Zemrës së Shenjtë të Jezusit e Zojës së Papërlyer, Eprorët tanë Hyjnor dhe ka si mbrojtës të veçantë Shën Mikelin Kryengjëll, Shën Jozefin e Shën Ndoun e Padovës.

"Rogate", si fara e sinapit 125 vjet më parë, sot është bërë një pemë aq e madhe sa degët e saj kanë tejshkuar botën mbarë me praninë e Bijave të Zellit Hyjnorë e të Etërve Rogacionistë. Këtu në Shqipëri jemi të pranishme që nga viti 1993 ,me dy bashkësi, në Pllanë dhe Shkodër. Për të qënë aktuale e besnike karizmës sonë përveç lutjes për thirrje, kemi kërkuar t'i vijmë në ndihmë nevojës më urgjente që na paraqitej atëherë. Ishin fëmijët me dëgjim të kufizuar.

Dhe së fundi t'i lëmë fjalën Atë Annibales, që të urojë e përshëndesë "Bijat e Zellit Hyjnor" kudo në botë me këtë lutje që ai vetë ka shkruar.

"Për të gjitha bijat e mia"

O Jezusi im, të lutem për shenjtërimin e këtyre bijave të mia, po i'a besoj Zemrës tënde të ëmbël e të lutem që në këtë Zemër Hyjnore ti t'i bësh të jetojnë e të vdesin.Të lutem o Jezusi im, ti drejtosh në udhët e tua deri në bashkimin më të përkryer të dashurise me Ty. Jezus shumë i dashur, mbretëro në mendjen e në zemrën e tyre; bëji që të shqetësohen për ty e merri në provaninë tënde Hyjnore te lutem o Jezusi im, ti mbështesesh me hirin tënd Hyjnor që të rriten nga virtyti në virtyt. Bëji të përvuajta, të dëgjueshme, të thjeshta, të urta,të pastra si engjëjt, të ëmbla, modeste e të durueshme.Shkëputi nga të gjitha gjërat e krijuara e aq më shumë nga vetvetja. Veçanërisht të lutem që të ngulitesh në zemrat e tyre një shpirt të zjarrtë lutjeje për qëllimet e zemrës sate të Shenjtë. O Jezusi im të lutem bëji që ato të duan shumë Nënën tënde të Shënjtë, Marinë e Shën Jozefin.Bekoji, o Jezusi im, bekoji me bekimet e tua të veçanta, bekoji me dashurinë tënde të pakuf. Jepu atyre qëndrimin e shenjtë final në shërbimin tënd të shenjtë. Të gjitha këto po t'i kërkoj, o Jezusi im, jo vetëm për këto, por për të gjitha ato që në të ardhmen do të bëhen pjesë e kësaj grigje të vogël. Amen.

Bijat e Zellit Hyjnor
Shkodër



Loreta Tomaj
Shkodër

NJERIU KJO QENIE E MISTERSHME

(Pjesa e njëzet)

VETËVLERËSIMI

5.3. Avantazhi i mbrojtjeve

Mekanizmat e mbrojtjes nuk të bëjnë të rritesh, por të lejojnë të mbijetosh. Në fakt, ofrojnë dy avantazhe:

- shmangin që personi të përballet me një stimul të brendshëm apo të jashtëm të rrezikshëm;

- mundësojnë shpërblime zëvendësuese dhe ulin në një nivel të durueshëm efektet e frustracioneve.

P.sh.: burri zihet në flagrancë nga gruaja e vet. Realiteti i thotë: "Ti je tradhtar!" (= plagosje e vetëvlerësimit). Ai mbrohet duke thënë: "Është e vërtetë, e kam bërë, por sepse ajo sillet ftohtë me mua dhe nuk kujdeset për mua" (projektim). Kështu, ajo që është larguar e para është gruaja, pra, ajo është tradhtarja morale (racionalizim): në fakt, tradhtia e zemrës është më e rëndë se ajo e mishit (intelektualizim). Avantazhi: burri shmang vështirësinë për të ndryshuar, e zgjidh veten nga faji, pret që gruaja të ndryshojë. Realiteti i thotë se është një burrë që zhgënjen, por e vërteta *e tij* psikologjike i thotë se është gruaja ajo që zhgënjen. Vetëvlerësimi i tij ka shpëtuar, në dëm të realitetit, por ka shpëtuar.

5.4. Niveli i mbrojtjeve

Personaliteti mund të organizohet rreth një sistemi mbrojtjesh, disa më qendrore dhe të tjera më periferike. Ato më qendroret shërbejnë për t'u mbrojtur nga një konflikt, kurse ato periferiket shërbejnë për t'i mohuar vetes sonë përdorimin e të parave. Pra, kemi një organizim mbrojtjesh në nivele të ndryshme. Kështu mund të flasim për dy lloje mbrojtjesh:

- *Mbrojtje strategjike*: janë operacione psikike qendore falë të cilave personi i bën ballë nevojave të veta fëmijërore. P.sh.: jam gjithmonë i gatshëm për të ndihmuar të tjerër, me qëllim që të vlerësohem prej tyre.

- *Mbrojtje taktike*: janë operacione psikike dytësore, që shërbejnë për të mos pranuar në mënyrë të vetëdijshme përdorimin e mbrojtjeve strategjike. Zakonisht janë më pak të pavetëdijshme se të parat. P.sh.: Mohoj, por vetes sime i them se nuk jam duke mohuar, por duke jetuar virtytin e durimit. E shkarkoj zemërimin tim mbi të tjerët, por e bind gjithnjë e më shumë veten se po luftoj për një ideal.

5.5. Hierarkia e mbrojtjeve

Hierarkia e mbrojtjeve mund të ndërtohet në bazë të dy ndryshoreve:

shkalla e shtrembërimit: një mbrojtje e caktuar *sa* e shtrëmbëron realitetin apo *sa* na bën të verbër? Mbrojtjet mund të ndahen në 4 shkallë, duke filluar nga shkalla 1 si më verbuesja.

- *Mbrojtje narçiziste*: aspekte të realitetit të jashtëm mohohen dhe nuk pranohen. Provat e jetës, që tregojnë të kundërtën e asaj që personi mendon apo do nuk e prekin vëmendjen e tij, e cila mbetet e verbër ndaj këtyre fakteve. P.sh.: Një fakt më krijon ankth? E shpërfill, kështu që për mua nuk ekziston më (mohim), tërhiqem në kështjellën time të fildishtë (largim shoqëror), ia vesh një tjetri (projektim), kthehem prapa në kohë (regresion), përpiqem ta fshij (anullim retroaktiv)...

- *Mbrojtje të papjekura*: realiteti nuk mohohet, por transformohet. Këtë personi nuk e bën duke manipoluar drejtpërsëdrejti realitetin, por duke vepruar në marrëdhënien me realitetin. Ai përpiqet t'i ndryshojë ndjenjat, që lindin nga ndeshja me realitetin e hidhur në mënyrë që përgjigjja emotive, tashmë e ndryshuar, të jetë e aftë për t'i dhënë realitetit një tonalitet të ndryshëm prej atij të

fillimit. P.sh.: Nuk ndihem i dobët, ndihem i pathyeshëm (gjithëpushtetshmëri), gjej një shpëtues të fuqishëm nën hijen e të cilit jam i sigurt (idealizim primitiv).

- *Mbrojtje nevrotike*: realiteti nuk pretendohet të jetë ndryshe, ai pranohet por i bëhet ndonjë ndryshim. Realiteti ri-interpretohet në mënyrë që të na sigurojë një përshtatje më të madhe shoqërore. Personi është i aftë t'u përgjigjet kërkesave shoqërore, por problemi i tij është i brendshëm (përshtatje psikologjike): marrëdhënia me ndjenjat vetjake. Kështu sapo provoj një ndjenjë të pakëndshme ia marr frymën (heqje), e neutralizoj me mendim (izolim), e justifikoj (racionalizim), e mbuloj duke vepruar krejt ndryshe (reagimi në të kundërt)...

- *Mbrojtje e pjekur*: mundëson pranimin e realitetit, mbarështimin e mirë të tij dhe të ndjenjave të brendshme. Në këtë pikë s'flitet për mekanizma mbrojtës, por për mekanizma të ruajtjes së kontrollit: hershim, pezullim, humorizëm.

Objekti i shtrembërimit: një mbrojtje e caktuar *çfarë* shtrembërimi krijon apo *për çfarë* na bën të verbër? Cili është problemi që kërkon një mbrojtje të caktuar? Të mbrohemi do të thotë se nuk përballojmë diçka: çfarë?

- *Probleme sjellore*: disa mbrojtje sugjerojnë një mospërshtatje jo vetëm psikologjike (mbarështim jo i drejtë i ndjenjave), por edhe shoqërore (paaftësi për të krijuar marrëdhënie si duhet me mjedisin). Ai që projekton nuk e pranon auto-kritikën, ai që pëson regresion e bën për t'u shmangur.

- *Probleme imazhi (vetjak apo të të tjerëve)*: edhe këto mbrojtje minojnë marrë-dhëniet shoqërore, por jo aftësinë për të punuar. Personi është i aftë të punojë, por jo të dojë, sepse ka një imazh jo realist për veten dhe për të tjerët.

- *Probleme vetëvlerësimi*: këto mbrojtje krijojnë probleme rreth përdorimit të potencialit vetjak psikik. Personi punon, krijon marrëdhënie, por është i paaftë për ta gëzuar jetën e vet. Logjika e kësaj mbrojtjeje e çon personin që të mos pranojë ndjenjat e veta, të cilat i përzgjedh dhe i çensuron. P.sh.: jam i pakënaqur, jam në krizë, asgjë s'ka vlerë!

- *Aftësi krijuese*: këto mekanizma të ruajtjes së kontrollit mundësojnë zotërimin e konflikteve (hershim), i shtyjnë për më vonë (pezullim), dhe i vlerëson me gjakftohtësi (humorizëm). Është personi i pjekur: i aftë të punojë, të dojë dhe ta gëzojë jetën.



Motër Simonetta Fenu
Shkodër

KJARA, GRUA E RE, NËNË E MËSUESE JETE DHE SODITJEJE

(Pjesa e fundit)

Qofsh Bekuar, o Zot, që më ke krijuar.

Jemi duke jetuar këtë vit 800-vjetorin e Kushtimit të shenjtës Kjara dhe atë të Themelimit të Urdhrit të Motrave Klarise. Është një moment hiri jo vetëm për familjen françeskane por edhe për të gjithë Kishën, për dhuratën e Kjarës së Asizit, e dashuruar me Krishtin, grua e re, e lirë dhe aktuale.

Kjara mësuese e soditjes

Edhe pse nuk mund të flitet për teologji të Kjarës në kuptimin e ngushtë, mund të flitet për reflektimin e saj mbi fenë. Teksti në të cilin del më mirë në pah kjo vetëdije e fesë është Testamenti. Në të Kjara rilexon për motrat e kohës dhe ato të ardhme thirrjen e bashkësisë së Sh. Damianit:

"Në të vërtetë, pikërisht Zoti na ka vënë si model, si shembull dhe pasqyrë jo vetëm për njerëzit e tjerë, por edhe për motrat tona, ato që vetë Zoti i ka thirrur ta ndjekin, në mënyrë që edhe ato të shkëlqejnë si pasqyra për të gjithë ata që jetojnë në botë" (Burime Françeskane 2829; Testamenti i Shën Kjarës).

Lutja e saj e soditjes vë në dritë mënyrën e saj të të jetuarit të Jezusit, pra, me vështrimin gjithnjë të ngulitur në Të, sikurse Maria. "Biri i Hyjit është bërë udha jonë" shpall Kjara në ngazëllimin e falënderimit me të cilin e hap Testamentin e vet. Soditja e saj nuk është gjë tjetër veçse ecje në udhën e Birit të Hyjit.

Në katër letrat e saj drejtuar Shenjtës Anjëz të Pragës, Kjara hap zemrën e vet duke përdorur shprehje dashurie, vlerësimi dhe admirimi të madh për Anjëzën. Në këto letra shpreh me ton intim dhe mirë besues shpirtin e vet, itinerarin e vet shpirtëror, diçka prej sekretit të soditjes së saj, nga të cilat, sipas dëshmive, kthehet "*me fytyrën më të bukur dhe më të kthjellët se dielli*".

Në këtë shprehje të shpirtit të saj pra bëhet mësuese për ne, që vihemi në dëgjim të përvojës së saj.

Qendra e Letrave është gjithmonë Krishti. Vështrimi që Kjara e mban të ngulitur mbi të është i thjeshtë, dashurues por gjithmonë teologjik. Prej aty del një vizion njësues i Misterit të Hyjit të Mishëruar. Prej Françeskut ka mësuar se Hyji i padukshëm është bërë i dukshëm dhe e sodit atë vazhdimisht.

"O përvujtëri e mrekullueshme, o varfëri që të mahnit! Mbreti i engjëjve, Zotëria i qiellit dhe i tokës është vënë në një grazhd! (Burime Françeskane 2904 - 4 Letrat drejtuar së Shenjtës Anjëza nga Praga *20 – 21).*

"Një Zotëri i tillë dhe kaq i madh, duke zbritur në kraharorin e virgjërës, deshi të dukej i përbuzshëm, nevojtar dhe i varfër" (Burime Françeskane 2865 - 1 Letër drejtuar së Shenjtës Anjëza nga Praga *19).*

Fjala "*pasqyrë*" është një fjalë kyçe në kulturën e epokës së Kjarës. Por, për Kjarën pasqyra nuk do të thotë vetëm të jetë shembull për të tjerët, sikurse thekson Françesku. Kjara ia vesh shëmbëlltyrën e pasqyrës drejtpërdrejt Krishtit, siç duket prej letrës së saj të katërt drejtuar Anjëzës së Pragës:

"Dhe meqenëse ky vizion i Tij është shkëlqim i lavdisë së amshuar, ndriçim i dritës së përhershme dhe pasqyrë e panjollë, çdo ditë sille shpirtin tënd, o mbretëreshë, nuse e Jezu Krishtit, në këtë pasqyrë dhe vëre në të vazhdimisht fytyrën e tij, në mënyrë që ti të mund të zbukurohesh krejtësisht përbrenda dhe përjashta, të vishesh e të rrethohesh me larmi, dhe le të jesh po ashtu e zbukuruar me lulet dhe veshjet e të gjitha virtyteve, siç të ka hije ty, o bijë dhe nuse tejet e dashur e Mbretit të mbretërve" (Burime Françeskane 2902 - 4 Letrat drejtuar së Shenjtës Anjëza nga Praga *14-17*).

Në këtë letër Kjara i thotë Anjëzës që ta shikojë çdo ditë këtë pasqyrë. Jezusi – pasqyrë, pra, nuk është vetëm një shëmbëlltyrë e thjeshtë që duhet imituar, por është një Person i gjallë që e përfshin dhe e shndërron atë që ndalet për të medituar misteret e tij.

"Prej kryqit Ai kërkon një përgjigje dashurie: "O ju të gjithë që kaloni rrugës, vëreni e shihni a ka dhimbje të ngjashme me dhimbjen time" (Burime Françeskane 2904-4 Letrat drejtuar së Shenjtës Anjëza nga Praga *25).*

Te këmbët e kryqit atëherë gjendet përgjigjja e Kjarës: *"Nuk do të më braktisë kurrë kujtimi yt dhe do të shkrihet në mua shpirti im" dhe "...* Të tërhequr nga ti,

pas teje do të vrapojmë" (Burime Françeskane 2904; 2906- 4 Letrat drejtuar së Shenjtës Anjëza nga Praga 26—28). Mundimi dhe vuajtja, duke u bërë përvojë bashkimi, janë edhe burim i gëzimit të brendshëm dhe zbulojnë misterin e haresë së pandryshueshme që e karakterizon Kjarën.

Nga pikësynimi i fundit i jetës së saj, përvoja martesore priret më shumë drejt plotësimit të amshuar, siç duket prej gjithë Letrës së katërt.

"Lum si ti! Të është lejuar të gëzosh këtë gosti të shenjtë, që të mund të bashkohesh me të gjitha fijet e zemrës tënde me Atë, Bukuria e të cilit është admirim i pareshtur i radhëve të lume qiellore". (Burime Françeskane 2901- 4 Letrat drejtuar së Shenjtës Anjëza nga Praga *9).*

Jezusi është dhëndri "që e ruan gjithmonë të papërlyer e të paprekur virgjërinë" (Burime Françeskane 2861 - 1 Letrat drejtuar së Shenjtës Anjëza nga Praga 7). Në përvojën e varfërisë përjetohet lumturia e atij që tashmë e zotëron Mbretërinë dhe ka marrë njëqindfishin. Pra, Kjara si "virgjër e varfër" është e lumtur të zotërojë Krishtin si Dhëndër të vetëm.

Letrat e saj janë të mbushura gjithnjë e më shumë me krejt përvojën soditëse të Shenjtës.

Kjara lavdëron me entuziazëm cilësitë e Dhëndrit të vet: "Fuqia e tij është më e fortë se çdo fuqi tjetër, bujaria e tij më e madhe, bukuria e tij më joshëse, dashuria e tij më e ëmbël dhe çdo favor i tij më i këndshëm" (Burime Françeskane 2862 - 1 Letrat drejtuar së Shenjtës Anjëza nga Praga 9). "Është më i bukuri ndër bijtë e njerëzve"(Burime Françeskane 2879 - 2 Letrat drejtuar së Shenjtës Anjëza nga Praga 20), "bukurinë e të cilit e admirojnë dielli e hëna, shpërblimet e tij janë me vlerë e madhështi të pafundme"(Burime Françeskane 2890 - 3 Letrat drejtuar së Shenjtës Anjëza nga Praga l6). Bukuria e



Jezusit admirohet në përvujtërimin dhe në vuajtjen në të cilat zbulon dashurinë e vet si dhëndër. Vështrimi i nuses është gjithmonë i drejtuar nga "pasqyra në të cilën shkëlqejnë "varfëria e lume, përvujtëria e shenjtë dhe dashuria e patregueshme". (Burime Françeskane 2903 - 4 Letrat drejtuar së Shenjtës Anjëza nga Praga l8). Është nusja që, pasi konsumohet oferta e saj tokësore, është e prirur nga bashkimi me Krishtin në një Shpirt të vetëm: "Eja, o Zot Jezus".

Përvoja e bashkimit martesor na kujton edhe temën e banimit hyjnor, të banesës së Trinisë në shpirt. Përvoja e banimit është pranë asaj të Virgjërës

Mari që e barti Krishtin në kraharorin e vet. "Shtrëngohu pas Nënës së tij tejet të ëmbël që, në qelën e vogël të kraharorit të vet të shenjtë barti Atë të cilin qiejt nuk mund ta mbanin". Është përvoja "amënore" e soditjes. "Dashuria", përmbushja e urdhërimit të Zotit të bën "nënë". Është aspekti i frytshëm i soditjes.

Në përfundim të jetës Kjara ndihet e dashur prej Hyjit Atë me kënaqësinë e një nëne të ëmbël. Është Ati që, pasi i ka dhënë Shpirtin Shenjt, e ka ruajtur gjithmonë me dashuri, si një bijë në Birin. *"Shko e sigurt në paqe... ai që të krijoi, më parë të shenjtëroi; dhe pastaj të krijoi, vuri në ty Shpirtin Shenjt dhe gjithmonë të ka vështruar sikurse nëna vështron birin e vet që do". Dhe shton: "Ti, o Zot, qofsh bekuar, sepse më ke krijuar" (Burime Françeskane 2986).*

Përmbajtja e soditjes së Kjarës, sidomos prej Letrave, na zbulojnë në njëfarë mënyre, marrëdhënien e saj me Hyjin. Por cila është metoda e saj e soditjes?

Kjara sigurisht që nuk mendonte të linte një traktat, por disa shënime i gjejmë ende në letrat e saj, sidomos në të dytën.

"***Shiko, medito dhe sodit, duke dëshiruar ta imitosh***": kjo nxitje e drejtuar Shenjtës Anjezë të Pragës, tregon shkalla të ndryshme progresive të një itinerari shpirtëror.

Është një rrugë soditjeje specifikisht të krishterë sepse është e bazuar në misterin e Mishërimit. Lind prej mahnitjes nga një Hyj që, megjithëse duke jetuar në një dritë të paarritshme, është bërë i dukshëm, i aftë të perceptohet prej aftësive tona njerëzore.

"Biri i Hyjit është bërë udha jonë" (Testamenti i Shën Kjarës 5).

1. Pra, hapi i parë është "*të shikojmë*": "Shikoje këtë pasqyrë çdo ditë". Shikimi që Kjara fton të kemi është me siguri para së gjithash një akt feje, që e përfshin gjithë personin, nxit dashuri dhe mallëngjim, është një përgjigje personale, në linjë me Shën Françeskun që e paraqet në Greço në mënyrë të ndjeshme Grazhdin. Shikimi është mbi Atë, Jezusin, një shikim i ndriçuar prej Fjalës së Hyjit. Dhe këtë Kjara e merr prej Liturgjisë dhe prej predikimit. "Kënaqej shumë duke dëgjuar Fjalën e Hyjit" (Burime Françeskane 3076).

2. Hapi i dytë i itinerarit soditës është "*të meditojmë*": pra, të shkojmë përtej shëmbëlltyrës së paraqitur për të vërejtur atë Fytyrë të Atit që Jezusi, Fjala dhe Shëmbëlltyra e gjallë, ka ardhur të na e zbulojë.

Ky hap i ditë kërkon veçanërisht "zemrën e pastër" sepse vetëm "të pastrit në zemër do ta shohin Hyjin". Në Kapitullin e dhjetë të Rregullës Kjara nxit "të lutemi gjithmonë me zemër të pastër". Zemra e pastër është zemra e heshtur, krejt e hapur nga dëgjimi. Krishti është i gjallë dhe na thërret në bashkim, në dhurim të ndërsjellë, në bashkëndarje.

3. Hapi i tretë i ecjes soditëse është "*të imitojmë*" : pra, dashuria shndërruese na angazhon të bëhemi Ungjill i gjallë. Ajo që Kjara sodit në pasqyrën e Birit të Hyjit, pra "varfëria, mundimi, lodhja, përvujtërimi, përbuzja", bëhet për të jetë e jetuar, Ungjill i mishëruar në gëzim, vulë e veprës së Shpirtit. Në të vërtetë, në Rregull pohon "ne nuk druanim asnjë varfëri, mundim, lodhje, përvujtërim e përbuzje të botës që madje na jepnin shumë hare (Burime Françeskane 2788; Rregulla e pavulosur të Shën Françeskut 6,2- Burime Françeskane 2832; Testamenti i Shën Kjarës 27 — 28). Kjo klimë e haresë së gëzueshme, e lumturisë ungjillore që i vërshon shkrimet e Kjarës, sidomos Letrat, janë pikërisht fryt dhe dëshmi e veprimit të Shpirtit të Zotit në zemrën e pastër të Kjarës, virgjër dhe e varfër në të cilën plotësohet Ungjilli.

Kjara, në ditët e fundit të jetës, merr vulën e ngjashmërisë së saj me Virgjërën. Motrat shohin në vegim se Zoja e Bekuar, e shoqëruar prej virgjërave, i afrohet dhe e mbështjell me një mantel qiellor, duke u përkulur mbi të në një përqafim (Burime Françeskane 3083).

Përfundim

Kemi nevojë ta shikojmë Jezusin me sytë e vëmendshëm, plot dashuri, plot fe. Kemi nevojë të meditojmë me dashuri e devotshmëri pasuritë që Hyji na dhuron në Jezusin, Fjalën e vet, Eukaristinë e vet. Kemi nevojë të kemi një zemër virgjër e të varfër, një zemër të pastër, për ta bërë të aftë të shohë dhe të pranojë Dashurinë e Hyjit, për ta bërë të dëgjueshme ndaj Shpirtit Shenjt që vepron në ne dhe që na bashkon me Jezusin, na shndërron, e bën të mundshme banesën e Trinisë në shpirtin tonë. Kjara, na ndihmo të jemi Prani e gjallë e Jezu Krishtit.

■

Dom Pren Kola
Vjenë

KAMBANA
TRAJTIM NË HISTORIN E NJERZIMIT

Kambana ka një batoq dhe, gjatë goditjeve me të lëshohet tingull i madh, ofshëtin me të madhe, ushton, qet dhe shpërndan andej-këndej një jehonë.

Kambana parashihet të jetë në përdorim tash e 5000 vjet. Ajo, bën të ditur arkeologjia, gjeti përdorimin e vet në të gjithë popujt e mëdhenj të antikës. Për to u shkruan monografi dhe vëllime të shumta librash, të cilat tregojnë për përdorimin e tyre nga babilonasit, kinezët, egjiptianët, romakët dhe grekët. Kina parashihet të jetë toka prej nga rrjedhin kambanat e para dhe që ato të kenë qenë që atëherë instrumente muzikore tondhënëse dhe shenjëdhënëse në veprimet kultike. Sipas teorisë indiane të muzikës të gjithë tingujt e njohur të instrumenteve muzikore bashkën në kambanë. Ajo, mendon kjo teori indiane, duhet të jetë shtëpia e tërë muzikës së shpikur, të kompozuar dhe të ekzekutuar, por edhe sinonim i muzikës në vetvete.

Në kohën para krishterimit kambanat e mbanin rolin e vet në procesionet e të vdekurve dhe kulti i kambanës përcillte rrugën nga jeta e përtejme, përmatanë varrit. Diodor Sikuli (Siculus † 30 para Krishtit), historian romak, duke treguar për jetën dhe vdekjen e Aleksandrit, përmend qerren e kufomës me një thekën (xhufkë) rrjetëzimi me kambana të mëdha. Për romakët thuhet të mos i kenë kushtuar shumë rëndësi kambanave, por prapë nuk hoqën dorë prej tyre, sepse dihet përdorimi i kambanave në kultin *kibele,* gjatë ngrënies dhe pirjes së verës. (Κυβέλη – sipas mitologjisë greke dhe romake – nena e madhe e zotave, e quajtur edhe: gr. *Megále Meter*, lat.: *Magna Mater)*.

Historiani Seuton († 122) në *Divus Augustus – Augusti hyjnor* përshkruan jetën e mbretit të parë të madh romak (63 para Krishtit dhe †14 pas Krishtit), të cilin e përmend edhe ungjilli i Krishtlindjes (Lk 2,1-4), që kishte vendosur kambanat në majën më të lartë të tempullit. Në botën pagane, në shumë rajone të botës, kambanat qenë përdorur si dekorim dhe bartës të fatit. Në hapësirat tona shqiptare ende mbahen mend thekat e kambanave të varura në kokat e kuajve, zakon magjik, i cili



na lidh me popujt e tjerë, duke filluar nga skitët e Kaukazit e deri në Evropën qendrore dhe Irlandë, ku në veçanti kuajt gjuetarë të mbretërve stoliseshin me xhufka.

Ndonëse kambana ka përdorim tejet të vjetër në shërbim të kultit, por edhe të magjisë, krishterimi i dha asaj formë dhe përcaktim liturgjik dhe kishtar. Kambana shërbeu në antikë edhe si mjet magjik për të larguar demonët dhe yshtjet. Por judaizmi dhe pastaj edhe krishterimi e futën në përdorim të kultit. Besëlidhja e Vjetër përmend së pari kambanat në librin e Daljes, duke u pas urdhëruar që guna e shpinores së Aronit të bëhet prej pëlhurës ngjyrë vjollce, të kuqe e të kuqe të mbyllur si shega e ndërmjet shegëve kambanëzat ari, që të jetë një kambanëz e një shegë, e një kambanëz e një shegë, dhe qe porositur të veshët me të Aroni kur të ketë kryer shërbesën. Qëllimi i gjithë kësaj ishte që të dëgjohet tingëllima kur ai të hyjë e të dalë prej shenjtërores (krhs. Dal 28, 31-35).

Kambana në krishterim

Në shekujt e parë të Kishës kambana simbolizonte shpalljen e Ungjillit. Shën Justini krahason 12 kambanëzat (kumbonëzat) me 12 fiset e Izraelit dhe me 12 apostujt si lajmëtarë të madhërisë së hirit të Krishtit. Shën Hipoliti († 258) përdorte kambanat gjatë këndimit të psalmeve, ndërsa për Shën Origjenin († 254) simbolizonin shpalljen e Lajmit të gëzueshëm të Krishtit që nga fillimi e deri në sosur të botës. Shën Antoni i Shkretëtirës († 356) paraqitet me kryqin dhe kambanat dhe thuhet që ai e dëbonte djallin dhe demonët me to. Mendohet që Shën Honorati († 430) të ketë sjellë kambanat në Evropë, Shën Augustini († 430) i quan: *signa sonantia – shenja tingëlluese*. Shën Saverini (†482), porsi rregullat e Shën Benediktit, i quan *signoque pulsatus* (*signum dare*) – shenja goditëse, mjete shenjëdhënëse për lutje të përbashkët, ulje në tryezë dhe punë. Shën Paulini i Nolës († 431) thuhet të ketë përdorur i pari kubanen për të dëftuar kremtimin e Meshës. Në jetën e shenjtërve kambanat patën rol të veçantë. Tregimet dhe legjendat për shenjtërit bëjnë të ditur për kambanën e thyer nga djalli të Shën Benediktit përderisa përmes një kambane po i lëshonte bukën Romanit, një monarku, që po jetonte jo larg kuvendit sipas rregullave të atit Adeodat. Jeta e Shën Liobës († 772) është e përcjellë me ëndrrën e nënës së saj me kambanë në gji, të cilës po i binte për të dëftuar lindjen e vajzës. Për Shën Eligin († 660), ipeshkvin dhe shenjtorin francez, thuhet që, për shkak të një mëkati të madh, ia kishte ndaluar një prift kremtimin e Meshës, duke përfshirë edhe rënien e kambanës. Por prifti i kërkonte që së paku t'i bjerë njërës prej tyre në kohën e lutjes dhe ia, disi tinëz, ia kishte lejuar, por kambana nuk kishte tingëlluar përderisa prifti nuk u pendua thellë dhe nuk kërkoi faljen nga ipeshkvi. Kur ipeshkvi i hoq dënimin, kambana filloi rishtazi të tingëllojë. Për papën Gegën e Madh († 604 Romë) në *Gesta Romanorum* thuhet të kenë filluar vetvetiu të bien të gjitha kambanat para që ai të hynte në qytet.

Përdorimi i rregullte i kambanave në Kishën katolike filloi në kuvendët rregulltare, pikërisht patën zanafillën te monarkët kopetë dhe eremitët egjiptian, pastaj u përcoll tradita te Shën Patriku († 461) në Irlandë, i cili priftërinjve që shuguronte pos një kryqi, katekizmi, meshari dhe rituali, u jepte edhe një kambanë. Që nga koha e papës Gegës së Madh, për të cilat thoshte që lajmërojnë bashkimin në fe, kambanat gjejnë vendin dhe futen në përdorim edhe jashtë kuvendeve. Papa Nikolli III († 1280) përcaktoi edhe kohën dhe rregullat e përdorimit. Kambanat së shpejti u bënë *Signum ecclesiae – shenjë e Kishës.*

Kambanat janë mjete liturgjike që ndihmojnë në kremtimin e Meshës. Jo vetëm zilja e altarit, por edhe kambanat bien dhe me tingullin e tyre tregojnë disa prej pjesëve kryesore të Meshës. Shpesh u bihet atyre kur të fillojë leximi i Ungjillit, kur të thuhet *Lavdi Hyjit*, në kohën e Shndërrimit (shugurimit të bukës dhe verës). Kambanat njëherë në vit heshtin. Në të Enjten e Shenjtë të Treditëshit të

Pashkëve, do të pushojnë së rëni deri në Meshën solemne të Pashkëve kur ka për t'u kënduar me gëzim të madh *Gloria* (Lavdi Hyjit në lartësitë qiellore).

Në famullitë katolike kambana bie në mëngjes (në agun e hershëm), në mesditë dhe mbrëmje (para që të ngryset). Në të tria vaktet bëhet me dije lutja *Engjelli i Zotit*. Kambanat bien rëndom të shtunave në mbrëmje për të bërë me dije besimtarët që janë afër kishës për Meshën e së dielës.

Kambanat trajtohen edhe si simbol i kalimit të kësaj bote; bëjnë thirrje për të përsiatur: *Memento mori – mendo vdekjen.*

Kambana a kambanat në Kishën katolike shpallin zotërimin, Mbretërinë e Jezu Krishtit në botë. Ato e përcjellin jetën e secilit të krishterë dhe bashkësitë famullitare në raste të ndryshme dhe situata të jetës. Kisha, kambanat, së bashku me organon, i mendon si pjesë të instrumenteve muzikore kishtare. Ato bëjnë thirrje për t'u bashkuar në Meshë, litani dhe devocione të shumta që zhvillon Kisha me besimtarët e vet. Në raste vdekjeje të ndonjë anëtari të famullisë kumbojnë për të treguar vdekjen e tij, por edhe për të bërë me dije dhe sjellë në mend lutjen që duhet bërë për anëtarin e famullisë që vdiq.

Kambanat u përdorën dhe ende përdorën edhe si shenjë a sinjale të rrezikut nga vërshimet, shtrëngatat dhe zjarret jo vetëm për t'u mbrojtur, por edhe t'u lutur për ata që kanë rënë në rreziqe. Gjatë shekujve janë të njohura: kambana e kushtrimit, kambana e lajmërimit të rrezikut dhe kambana e fitores.

Kambana e ngritur në kambanarë përmes tingullit të vet e bën kishën të vërehet. Përmes kambanës, në mënyrë akustike, e ndiejmë kishën, e kemi afër dhe përmes tingullit të kambanës bëhet pjesë e përditshmërisë sonë.

Kambanat që bien dhe kumbojnë, secila me tingullin e vet të veçantë, janë shenjë e lirisë së fesë. Gjatë dekadave të shumta në Shqipëri nuk tingëlloi dhe nuk u dëgjua zëri i kambanave. Kjo ishte shenjë e mungesës së lirisë së fesë, mungesës së shprehjes së besimit dhe botëkuptimeve të tjera ndryshe nga komunizmi. Prapa kësaj heshtjeje fshihej një e zezë e madhe që i ndodhi katolicizmit shqiptar. Sot kur prapë po bien kambanat edhe në Shqipëri, së bashku me jehun e tyre po jep dëshmi edhe gjaku i martirëve të shumtë. Mbi gjakun e martirëve po rritet Kisha. Jehona e kambanave po bën me dije që Shqipëria ka nevojë për Zotin.

Në Kosovë, Mal të Zi dhe gjetiu ku jetonin shqiptarët, edhe pse feja a besimi ishin të mënjanuar dhe në një masë të kontrolluara, prapë ushtroheshin lirisht dhe kambana binte me rregull. Të gjithë ata që kishin shtëpitë afër kishës e dëgjonin atë dhe shpesh edhe orientoheshin sipas vakteve të saj, bënin kryq kur ajo binte dhe e kuptonin sidomos kohën e mesditës. Rëndom përmes kambanës, sikurse edhe sot, qenë bërë me dije të tria vaktet e ditës për lutjen *Engjelli i Zotit*, por lajmërohej edhe koha e Meshës, festat e mëdha, vdekja e anëtarëve të famullisë; bëhej edhe përcjellja e funeralit deri te varri me gjysmën e zërit të kambanës, për të cilën populli thotë: *po bie kambana në njërën atë, ose po bie tek,* gjë që ishte shenjë vdekjeje. Të vjetrit e devotshëm në familjet tona kur binte kambana na thonin: *"Bâni kryq se ky âsht zani i Zotit"*. Pra në familjet tona zëri i kambanës kishte krijuar një përshpirteni të veçantë dhe ishin shumë, sidomos gra e të moshuar në përgjithësi, që luteshin kur binte ajo.

Kambana vërtet edhe sot me tingullin e vet na fton në lutje, bën të mos harrojmë se ekzistojnë kishat ku kremtohet Mesha e Krishtit dhe rri Krishti eukaristik; na përkujton që jemi të krishterë; është shenjë akustike e fesë sonë dhe ballafaqe simbol i krishterimit.

Në Shqipëri, që në ditët e para të janarit të vitit 1938, pa dritën e botimit revista *Kumbona e së Diellës*. Kjo revistë me një emër domethënës dhe kuptimplotë, pos në kohën e ndalimit të fesë gjatë komunizmit, qe zëri i Ungjillit dhe i Kishës. "Kumbona" shpirtëzoi dhe po vazhdon t'i shpirtëzojë edhe tani zemrat e besimtarëve dhe po i rrit lexuesit në fenë, shpresën dhe dashurinë e Krishtit.

ARSIMIMI PËR ATË GJERGJ FISHTËN ISHTE NGRITJA E NIVELIT TË VETËDIJES

Zbulimi i bustit, Atë Gjergj Fishtës në Jagodë – Komuna e Klinës, Kosovë, më 12 prill 04-11, 2012

Atë Gjergj Fishta ishte krijues i gjithmbarshëm, françeskan i dëvotshëm, meshtar i zellshëm, mjeshtër i fjalës së shkruar, njëri ndër intelektualët më të spikatur shqiptar të kohës së tij. Përpos filozofit dhe teologut, që janë pregatitje e domosdoshme për çdo meshtar katolik, ai ishte shkrimtar, historian, pedagog, piktor (me më se 20 piktura), deputet, përfaqësues dhe mbrojtës i Shqipërisë në botë, kandidati i parë shqiptar për Çmimin Nobel.

Kryevepra e tij, dhe jo vetëm e tij, por edhe e letërsisë shqiptare, është padyshim *"Lahuta e Malcis"*, të cilën e kishte shkruar, përpunuar dhe trajtuar afro 35 vjet, mos të them gjatë tërë jetës së tij, me rreth 16 mijë vargje, në të cilën trajton sundimin shumëshekullor turko-otoman si dhe rrezikimin e mëvonshëm nga bota sllave, por edhe vlerat dhe virtytet tona iliro-shqiptare si mikpritja, bujaria, besa, flijimi, guximi, trimëria, një lloj "testamenti shpirtëror" për ne Shqiptarët.

Atë Gjergj Fishta rëndësi të veçantë i jepte shkollimit, arsimimit dhe qytetërimit të shqiptarëve, si parakusht për lirë të vërtetë dhe të mirëfillët. Shkolla dhe gjuha shqipe ishin dy shtylla të forta për edukim dhe atdhedashuri, apo si thoshte ai "*zeje të shenjtë*". Binomi i njohur dhe i shenjtë i klerit katolik shqiptar "*Fe dhe atdhe*" te atë Gjergj Fisha gjetën zbatimin dhe konkretizimin shumë të qëlluar dhe providencial: "*Për gjuhën dhe shkollën shqipe*".

Arsimimi për atë Gjergj Fishtën ishte ngritja e nivelit të vetëdijes, kulturës dhe edukimit, që do të kurorëzohej në procesin e qytetërimit, parakusht pa të cilin s'ka as liri, atdhedashuri, popull dhe shtet të mirëfilltë.

Dikur të tjerët, të huajit na mohonin historinë, gjuhën, traditën, kulturën, identitetin tonë kulturor dhe fetar, duke na vrarë, penguar dhe ndaluar që të jemi vetvetja, sidomos sundimtarët shekullor turko-otoman dhe sllavë.

Sot këtë gjë ia bëjmë vetvetes duke i mohuar dhe sulmuar personalitetet tona madhore historike dhe aktuale, duke u nisur prej Gjergj Kastriotit – Skëndebeut, Nënës Tereze, atë Gjergj Fishtës dhe shumë të tjerëve, si një vetëvrasje tragjike shpirtërore dhe kulturore, si përdhosje të historisë dhe rrezikim të së tashmes dhe të ardhmërisë.

Përse jemi të tillë?

Sepse, si duket fatkeqësisht, për ne Shqiptarët, nuk ka vlera dhe virtyte të pacenueshme dhe të paprekshme, na mungon barometri për ta vlerësuar vetveten dhe të tjerët. Dikush mjeshtrisht tha: *"Bota vuan sespe ka pak njerëz të mençur. Shqiptarët vuajmë sepse të gjithë jem të mençur"*.

Servilizmi dhe oportunizmi ynë tashmë i njohur, të nënshtruar ndaj të fortit, dhe të fortë me të dobëtin, na solli deri te antitezat që edhe sundimtarët pesë shekullor turko-otoman na qenkan *"vëllazer, miq, të gjakut tonë"*, bile edhe "*bamirës dhe çlirimtarë*"!. Ky proces do të zbatohet herdo-kurdo edhe për Serbët apo çdokend tjetër, sepse si duket jemi bërë tashmë *"shoshë"*, ironia e fatit tallet me ne. Pluralizmin dhe demokracinë e interpretojnë në mënyrën tonë arbitrare dhe të përçudëruar.

Ju përgëzoj për këtë vepër, që atë Gjergj Fisha të jetë me bustin e tij në oborrin e shkollës së Jagodës, duke shpresuar dhe uruar që edhe më tepër të jetë i mishëruar në mendjet dhe zemrat e fëmijëve tanë, si frymëzim për shkollimin dhe edukimin e tyre, për histori, të tashme dhe ardhmëri më të mirë të mbështetur në virtytin e së vërtetës dhe të dashurisë. URIME!

Dom Lush GJERGJI



Zbulimi i Bustit "Atë Gjergj Fishta" në Jagodë - Klinë më 12 Prill 2012

Prof.dr. Tomor Osmani
Universiteti i Shkodrës

DOM DODË KOLECI DHE GRAMATIKA NË SHQIP

Ndër veprat me karakter gjuhësor të njohura të dom Dodë Kolecit, janë dy botime: "Gramatika shqiptare..." dhe "Fjalori i shoqërisë "Bashkimi" (1908).

Ma e para gramatikë gegnishte për shkollat shqipe (1901)
At Justin Rrota

Jemi në vitin e parë të shekullit XX, kur shoqëria "*Bashkimi*" në Shkodër 110 vjet më parë botoi *"Grammatika ia folmarmia shqyptare, e përmledhme me pak fjalë për përdorim t'fmiive"*. Kjo shoqëri, e themeluar në vitin 1899 nga abati i Mirditës Preng Doçi, në programin e saj kishte disa objektiva të rëndësishme në fushën e kulturës, si: hartimin e një alfabeti të shqipes, mbështetur në atë latin dhe pranonte edhe dyshkronjëshat për të paraqitur një tingull-fonemë. Gjithashtu ajo do të botonte një abetare, një gramatikë, një fjalor, si edhe vepra letrare dhe fetare, tekste mësimore dhe do të nxirrte një organ periodik. Detyrën e parë e kreu që në krijimin e saj, duke hartuar alfabetin që njihet si alfabeti i shoqërisë *"Bashkimi"*, i cili u përdor nga mjaft organe dhe shkrimtarë të dëgjuar të kohës, duke i shërbyer shoqërisë shqiptare që ajo të mos përdorte një mori sistemesh shkrimore dhe autorët të mos përdornin alfabetin që dëshironin. Alfabeti i autorëve të vjetër që përdorej në Shkodër nga ndonjë fletore e kohës, shkrimtar apo në letërkëmbimin privat, nuk gjeti mbështetje dhe përhapje, ndonëse iu bënë disa ndryshime të vogla dhe stilizim shkronjash.

Alfabeti i shoqërisë "*Bashkimi*", megjithëse u përhap shpejt, nuk arriti të bëhej kombëtar . Edhe gramatika , të cilën po analizojmë, zbatoi sistemin shkrimor të asaj shoqërie, pasi ajo e botonte këtë vepër. Ndryshe nga shumë botime të kohës që çdo vepër fillonte me një pasqyrë të alfabetit që do të përdorte, autori nuk e bën në gjë të tillë në fillim të saj, por, kur trajton çështjet fonetike, shënon se alfabeti i shqipes kishte 35 shkronja : 6 zanore dhe 29 bashkëtingëllore dhe cilat ishin ato. Alfabetin e jep , (që është i shoqërisë "Bashkimi"), por pa bërë asnjë sqarim. Duket se autori e ka parë si diçka të


Dom Dodë Koleci

panevojshme të mos japë shpjegime, pasi alfabeti i shoqërisë "Bashkimi" ishte publikuar dy vjet më parë.

Autor i kësaj gramatike është pranuar dom Dodë Koleci.

* * *

Kush ishte dom Dodë Koleci? Famullitari dom Dodë Koleci lindi në Kallmet prej një familjeje nga Selita e kësaj krahine në mes të shekullit XIX dhe vdiq në Ndërfanë të Mirditës, më 17 shkurt 1915. Ai ka shërbyer në hirarkinë kishtare prej afër 40 vjet, si famullitar në Orosh të Mirditës, Blinisht, Kaçinar, Mnelë e së fundi kohën më të gjatë prej 21 vjetësh e kaloi si famullitar në Ndërfanë derisa vdiq. Në të njëjtën kohë vdiq edhe atë Anton Xanoni, mik dhe shok i ngushtë i autorit.

Famullia e Ndërfanës në atë kohë nuk kishte më shumë se 700 shtëpi. Për Pashk Bardhin dom Dodë Koleci qe një ndër priftërinjtë më të dishëm të Mirditës dhe një ndër më të vlefshmit shkrimtarë të shoqërisë letrare "*Bashkimi*". Ka qenë mësuesi i Pal Treshit, krah i djathtë i Preng Doçit. Kalendari i vitit 1919 thekson se "*D.Dodë Koleci ka qenë shok i ndeztë i të paharrueshmit Anton Xanonit në lamë të literatures, ju ba shok edhe në dekë."*

Ndër veprat me karakter gjuhësor të njohura të dom Dodë Kolecit, janë dy botime: "*Gramatika ia folmarmia shqiptare…"*(1901) dhe *"Fjalori i shoqërisë "Bashkimi*" (1908).

Shoqëria "*Bashkimi*" e kishte si orientim të saj të mos përmendej autori dhe të mos shënohej viti i botimit. Dhe për këtë shënon: " *Cum approbatione superiorum*"(=me miratimin e eprorëve). Atëherë kush qe autori i kësaj gramatike dhe i Fjalorit të vitit 1908? Për këtë studiuesit e ndryshëm kanë dhënë mendime si për vitin e botimit , ashtu edhe për autorin. Jup Kastrati, duke u mbështetur te bibliografia e Henri Gûys e vitit 1912 pranon mendimin e tijj që thotë: " *Ka mundësi që kjo gramatikë të jetë botuar në Shkodër rreth vitit 1901."* Dhe këtë Kastrati e bën fakt të kryer. Edhe përsa i përket autorit të kësaj gramatike, pranohet se është dom Dodë Koleci, mbështetur në këto të dhëna: Revista "Përparimi" e vitit 1915, nr. 3, pra shumë afër botimin të kësaj gramatike shkruan se "*Folmarmia ase gramatika" dhe Fjalori i Bashkimit janë gadi krejt fryti i mundit t'nder.Dom Dodë Kolecit. Pos ktyne ka lanë edhe shkrime tjera t'vjefshme për gjuhë e letratyrë tonë"*. Ky informacion i kësaj reviste shtron nevojën që të bëhen kërkime për të gjetur edhe shkrime të tjera të këtij gjuhëtari. Një ide e tillë për autorin dom Dodë Koleci është përsëritur edhe në Kalendarin e vitit 1919, Vepra pijore. E përforcon një mendim të tillë edhe Pashk Bardhi në një shkrim për Pal Treshin të botuar në vitin 1939 te revista "Kumbona e së Diellës". Ai shkruan: "*D.Dodë Koleci* (shën.T.O.) *si pjestar i ksaj shoqnije* (Shoqnisë "Bashkimi", T.O.) *shkroi gramatikën dhe fjalorin e gjuhës shqipe*.)

Për disa autorë është pranuar se Fjalori është fryt i një pune të përbashkët dhe bashkëpunimi të disa anëtarëve të shoqërisë "Bashkimi", ndonëse dëshmi të tjera autorësinë, siç e përmendëm, ia japin dom Dodë Kolecit, të cilin Preng Doçi e donte dhe e çmonte shumë "*për zgjuesi mendjeje, për kulture e për zotsi ndërmarrjeje"*.

Për Karl Gurakuqin dom Dodë Koleci është kryepërpiluesi i Fjalorit. Edhe P.Duka-Gjini një fakt të tillë e pohon , kur shkruan: *"Dihet se autori kryesor i këtij fjalori asht dom Dodë Koleci edhe pse emni i tij nuk del në pah në botimet e asaj kohe , ashtu si s'figuron emni i kurrnji nga anëtarët e veprave të botueme nga "Bashkimi". Kjo asht normë e rregullores s'shoqnisë vlerëplotë.*

Justin Rrota në veprën " *Litratyra shqipe*" (Shkodër, 1925) në rreshtimin që u bën gramatikave më me rëndësi për gjuhën shqipe, duke nisur me gramatikën e Da

Leçes të vitit 1916 e duke vazhduar me 10 gramatika të tjera, ndalet tek "*Gramatika ia folmarmia shqyptare*" e shoqërisë "Bashkimi." Shënon vetëm vitin e botimit, 1901, por jo autorin. Ai thekson se "Gramatika…" (T.O.) nuk ka shumë randësi gjuhësore " *përposë se asht ma e para gramatikë e gegnishtes për shkollat shqipe*".) Për historinë e gramatikave të shqipes vlera e saj qendron se është gramatika e dytë shqip pas asaj të Sami Frashërit, që është më e para gramatikë shqip, toskërisht, për shkolla. "Shkronjëtorja…" e Sami Frashërit dallohet si nga vëllimi, ashtu edhe nga trajtimi shkencor i problemeve gjuhësore. Vlerësimi i Rrotës pas 25 vjetësh që ishte botuar "*Gramatika ia folmarmia shqyptare*", kur mendimi gjuhësor pas shpalljes së pavarësisë, kishte fillur të ecë dhe pas vitit 1901 ishin botuar 5-6 gramatika në shqip, duhet parë me kohën kur u botua ajo, kur ato pak shkolla në gjuhën shqipe që ishin hapur, nuk kishin fituar një fizionomi të kristalizuar dhe kur ende nuk ishte zgjidhur përfundimisht alfabeti i përbashkët i gjuhës shqipe.

* * *

A ka pasur kjo gramatikë ndonjë ndikim te pasardhësit? Duke ditur se mendimi gjuhësor po evoluonte, ndikimi i tij mund të jetë i papëfillshëm në gramatikat e mëvonshme. Në vitin 1909 Anton Xanoni botoi tekstin "*Gramatika shqyp*" ndonëse para dhe mbas vitit 1901 kishin qarkulluar edhe gramatika të tjera, . Xanoni shënon në hyrje se "*mbas gramatikave të P.Jungut, t'Folmarmes të "Bashkimit" e t' Shkrojtores së Sami Frashërit e qitme këtë tonën.*" Nga kjo marrim vesh se Xanoni mund ta ketë pasur parasysh këtë gramatikë, ndonëse teksti i tij



Shoqëria Bashkimi - Shkodër

është shumë më i gjerë, më i plotë dhe metodikisht më i saktë dhe nga studiuesit është konsideruar " *një tekst relativisht i mirë.*". Kështu nuk mund të flasim për ndonjë ndikim , se modele mund të merren jo vetëm nga gramatikat e botuara të gjuhës shqipe , por edhe nga gramatika të gjuhëve të huaja.

Çfarë përmban kjo gramatikë?

"Gramatika ia folmarmia shqyptare" është ndërtuar si tekst mësimor, në gegërisht për shkollat shqipe, ndonëse në kushtet e pushtimit. Dihet se edhe në atë kohë u bënë përpjekje për të hapur shkolla në gjuhën amtare, pavarësisht nga raprezaljet që mund të kishin autorët e tyre. Kujtojmë vrasjen apo helmimin e shumë patriotëve shqiptarë që luftuan për përhapjen e gjuhës dhe të shkollës.

Gramatika ka gjithsej 73 faqe dhe 9 krerë. Në tri faqet e fundit jepen termat që janë përdorur në tekst, me gjegjësen në italisht.

Temat e ndryshme shoqërohen me pyetje që duhet të përgjigjen nxënësit. Pra është një aparat pedagogjik i thjeshtë.

Ka njoftime të shkurtra për fonetikën, shumë pak për sintaksën e drejtshkrimin dhe më shumë për morfologjinë. Fillimisht jep të dhëna se ç'është gramatika, fjalët dhe shkronja, zanoret e shkurtra, të mesme dhe të gjata, ilustruar këta me shembuj. Bën ndarjen e bashkëtingëlloreve sipas vendit të formimit, duke dalluar bashkëtingëllore buztore, qiellzore, dhamtore, gryktore, fishkllore (Termat janë të autorit të gramatikës).

Autori bën edhe sqarime drejtshkrimore, si mdërmjet shkronjave **t** dhe **s** e ndërmjet **t** e **h** do të vihet zanorja e që të mos ngatërrohet me **ts** dhe me **th** e me **t** të vetme. Jep shembullin *leeteshem, aviteshem, tehiek*. Kështu vazhdon edhe në disa pjesë me sqarime drejtshkrimore. Në ato pak rreshta që trajton problemet me karakter fonetik, jep të dhëna për fjalët njërrokëshe e shumërrokëshe, dyzanoret dhe trizanoret. Theksit në gjuhën shqipe i jep një vend më të gjerë se pjesët e tjera. Pastaj shënohen disa nga fenomenet fonetike të shqipes dhe përdorimi i apostrofit.

Dom Dodë Koleci i ka dhënë një vend fare të vogël njohurive sintaksore, si kryefjalës, kallëzuesit, cilësorit dhe plotësorit. Nuk i ka anashkaluar shenjat e pikësimit, duke dalluar pikën, dy pikat, pike presjen, pikë pyetjen, pike çuditjen, duke përcaktuar tepër shkurt se çfarë shënojnë ato. Në këtë pjesë janë shënuar edhe pjesët e ligjeratës , që autori dallon nëntë të tilla, duke i ndarë në pjesë të ndryshueshme : emri, nyja, mbiemri, përemri, folja dhe në pjesë të pandryshueshme: ndajfolja, parafjala, lidhëza dhe pasthirrma. Nuk njeh numërorin dhe pjesëzën.Të gjitha këto janë përfshirë në hyrjen të titulluar "*T'njoftme paraprake*".

Kreu i parë i kushtohet emrit, ku dom Dodë Koleci jep veçoritë e tij. Po ndalemi në ndonjë problem të veçantë për këtë kategori leksiko-gramatikore. Autori i njeh emrit shtatë rasa, duke përfshirë edhe rasën vendore që ai e quan vendtore: *n'burret, n'mikt*. Pranon thirroren (e quan thirrtore) *o burrë*, ngatërron paradigmat e emrit, duke njëjtësuar të shquaren me të pashquaren në gjinore, dhanore dhe rrjedhore dhe gjinoren nga dhanorja.

Nyja është trajtuar fare shkurt në kreun e dytë ku gabimisht është përfshirë edhe parafjala prej. Në kreun e tretë dhe të katërt trajton mbiemnin dhe përemrat.

Ndërsa në kreun e pestë trajton foljen që i ka dhënë vend më të gjerë në tekst, gati gjysmën e librit f. 23-65. Për foljen pranon gjashtë mënyra të shtjelluara, duke përshirë kushtoren dhe habitoren dhe tri të pashtjelluara: pjesoren, paskajoren dhe përcjelloren. Për dëftoren pranon tetë kohë, ndërsa për urdhëroren dy kohë: të tashmen



dhe të ardhme? Tek lidhorja përfshin edhe lidhore- habitoren, ndërsa për kushtoren shënon se ajo ka gjashtë forma të cilat nuk i përkasin të gjitha kësaj mënyre, kur dimë që ajo ka dy kohë të tashmen dhe të kryeren. Habitores i njeh një kohë, ndërsa dëshirores katër. Nuk është e vështirë për të kuptuar se autori i ka ngatërruar kohët e foljeve të mënyrave të ndryshme.Dallon tri zgjedhime, ndarjen e të cilave i bën duke u mbështetur te paskajorja gege. Zgjedhimi i parë përfshin ato folje që dalin me togzanor: *me mësue* , folet e zgjedhimit të dytë dalin me të: *me avitë*, ndërsa i treti me çfarëdo mbarese në bashkëtingëllore: *me lidhë.* Foljet të cilat pësojnë ndryshime fonetike i quan të parregullta, si: *shoh, marr, ha, them* etj. Paradigmat e foljeve të parregullta i ka dhënë në formë tabelash sipas mënyrave të foljeve. Fillimisht jep zgjedhimin e foljeve *kam* e *jam.* Pastaj paraqet format pësore dhe vetvetore të foljeve, sipas autorit, vetëm me foljen ndihmëse *jam.* Jepen edhe paradigmat në këtë formë që sot nuk përfshihen në sistemin foljor të shqipes. Nuk janë shënuar edhe ndërtimet joveprore me mbaresa të veçanta dhe me formantin u.

Katër krerët e tjerë, gjashtë deri në nëntë u kushtohen pjesëve të pandryshueshme të ligjeratës, duke filluar me parafjalët. Kur autori flet për parafjalët i ndan në të vendit, të kohës, të shoqnisë dhe të mënyrës.

* * *

Siç e shënuam në fillim të këtij shkrimi, në tri faqet e fundit janë shënuar termat e përdorur në tekst. Jup Kastrati edhe këtë tekst e ka përfshirë në monografinë "*Për historinë e gramatikave të shqipes*", Prishtinë, 1980, f. 242-244. Ai shënon se vlera e këtij libri qendron në përdorimin e terminologjisë gjuhësore.[10]

Tek ky fjalorth duhet të veçojmë se çfarë termash gjuhësorë i takojnë kësaj gramatike dhe çfarë u takojnë autorëve paraardhës dhe çfarë mund të ketë mbetur. Theksojmë se jo të gjitha fjalët e shënuara në fjalorth janë terma gjuhësorë.

Ndonëse vlera e kësaj gramatike nuk është e madhe, pasi ka edhe interpretime jo të sakta dhe në disa raste edhe gabime, por ne mund të zbulojmë se në ç'shkallë ishte mendimi gjuhësor një shekull më parë dhe mund të marrim ndonjë të dhënë me interes dialektologjik për atë kohë për krahinën që përfaqëson kjo gramatikë. Vlerësimi duhet parë gjithashtu edhe me përgatitjejen filologjike që ka pasur autori i saj. Nuk dimë nëse autori i ka njohur botimet me karakter gjuhësor, që kanë qarkulluar para tij, gjë që është e ditur se ka pasur, pasi gramatika nuk ka të dhëna të tilla.

Është detyrë e obligim i brezave që të vlerësohet puna e paraardhësve në kushtet e pushtimit, pavarësisht nga vlerat ose jo vlerat që mund të kenë. Me këtë sens duhet parë edhe "*Gramatika ia folmarmia shqyptare , e përmledhme me pak fjalë për përdorim t'fmive*" e dom Dodë Kolecit.

Ndue Dedaj
Rrëshen

MONUMENTET PEZULL!
(Në 100-vjetorin e Pavarësisë)

Buste që bien e ngrihen!

Në një nga mbledhjet e Qeverisë të muajve të fundit, Kryeministri Berisha, shpalli se do të ndërtohej një monument i ri për Pavarësinë, për çka do të bëhej dhe një konkurs, ndërkohë që nga Vlora pati zëra se tempulli i Pavarësisë ishte atje, te Sheshi i Flamurit, duke e quajtur të tepërt këtë monumentin e ri. Sipas mediave, mbetej e paqartë nëse monumenti aktual në Vlorë do të zëvendësohej nga ndonjë monument tjetër, apo ky i riu do të vendosej diku tjetër. Pa i hyrë diskutimit për rastin konkret, problemi është se ne ende nuk kemi gjetur mirëkuptim për çka lidhet me memorien hisorike dhe simbolet kombëtare. E thotë njëri, s'e thotë tjetri. Prandaj na duket se kjo puna e monumenteve është një shaka me historinë, që ne pasardhësit e heronjve e bëjmë si të duam. Një monument mund ta ngresh të ri, mund ta rrëzosh nga themelet, mund ta lëvizësh për diku tjetër, pa dashur t'ia dish për askënd. As për historinë, as për publikun, as për ligjin.Të gjitha këto kanë ngjarë në këto njëqind vjet. Kanë qenë të shumtë monumentet që kanë rënë pas 90-ës, ndër të cilët dhe "Heroinat e Mirditës", për çka ekspertët e artit kanë bërë kritika. Në Burrel, në 2009-n, lëvizet shtatorja e Skënderbeut, për t'i lëshuar vendin asaj të Mbretit Zog. Pati atëherë një përplasje mes këshilltarëve të djathtë e të majtë, nëse duhej të lëvizte apo jo "Heroi Kombëtar", për t'i lëshuar vendin "Mbretit të Shqiptarëve". Është e pesta herë, që monumentit të Luftëtarit Kombëtar në Korçë i vihet vinçi, për ta lëvizur për diku tjetër. Kështu ky luftëtar famëmadh ka mbetur sërish në "lëvizje", sikur ishte i gjallë në çetat e Pavarësisë. Është ndoshta monumenti më i vjetër në Shqipëri (i vitit 1932) dhe autorit të tij, skulptorit të madh Odise Paskali, zor se i kishte shkuar ndërmend se ai monument mund të lëvizte, sa në një kënd të qytetit në tjetrin, për t'i lëshuar vend herë këtij, herë atij ndërtimi të ri, së fundi për shkak të ndërtimit të katedrales. Fat dhe më të keq ka patur monumenti i Heronjve të Vigut, që nga lulishtja në qendër të Shkodrës, lëvizi për diku tjetër, për t'i lëshuar vendin xhamisë, që u ndërtua në fillim të viteve '90. Por vetëm disa vite më pas do të shkulej dhe prej aty dhe do të dërgohej në periferi, pranë varrezave të dëshmorëve, dhe në vend të tij do të lartohej një ujëhedhës modern në formë obelisku. A janë pyetur ndonjëherë qytetarët, zotërit e një qyteti, për këto lëvizje heronjësh në mermer, që del se janë "nomenklaturë" e pushtetit? A u pyetën ata dhe atëherë kur në zemër të Tiranës u vu shtatorja modeste e Sulejman Pashës, si kinse themelues i saj, në një nga kryqëzimet e qendrës, si ndonjë zotëri kujdestar i trafikut, ku nuk vihet ndonjëherë kurorë, tufa lulesh, nuk mbahet ndonjë ceremoni e për të cilin deri më sot nuk kemi lexuar dy rreshta. A thua ky të jetë stadi i monumenteve në këtë vend? Dhe teksa bien e ngrihen buste, befas përmes ekranit kundron bustin e Petro Nini Luarasit në vendlindje, as i rënë, as i parënë, që ka mbetur i vetmuar, pasi fshati është braktisur nga banorët, dhe s'ke si të mos thuash me shqetësim: ç'po ndodh kështu me bustet? Memorien e gdhendur të kombit tonë? A mundet që një figurë e tillë e arsimit kombëtar të lihet kështu në harresë? Ai ra një shekull me parë, me 1911, në vigjilje të Pavarësisë, një motiv më shumë për ta risjellë në kujtesë sot.

Por duket se problemi i busteve dhe përmendoreve nuk është vetëm shqiptar. Në Shkup, jo pa vëmendjen e mediave të rajonit, u vendos në përmasa gjigande shtatorja e Aleksandrit të Madh,



Abat Prengë Doçi

duke shkaktuar reagim tek shteti fqinj grek, ku siç dihet mes tij dhe Maqedonisë ka një konflikt për emrin, që nuk po zgjidhet. Politika, ashtu si dje, nisur nga ideologjia ka thirrur në ndihmë bustet. Me bustet në Ballkan bëhet politikë dhe gjeopolitikë. Por dhe me gjerë se Ballkani. Në Ukrainë kohë më parë është përuruar busti i ri Stalinit, vendosur para selisë së Partisë Komuniste. Ai bust që qe rrëzuar me dhjetëra herë në qytetet e Lindjes me rastin e rënies së Murit të Berlinit, përfshi edhe në Shkodër. Diktatori sovjetik, edhe sot që nuk ka histori, ka nostalgjikë dhe militantë. Por pamja e monumentalitetit bashkëkohor bëhet dhe më e larmishme, kur mendon se jo vetëm diktatorët ngrihen e ringrihen në piedestale, por dhe humanistët dhe iluministët e mëdhenj, si Martin Luter Kingu, lartuar së fundi në një shtatore madhështore në Uashington, ashtu si prej providencës vazhdojnë të ngrihen statujat e Jezusit, ku e fundit, më e madhja në botë, pas atyre të Bolivisë e Brazilit, është ndërtuar në Poloni, 50 metra e lartë dhe 24 metra e gjerë, që do të shihet nga autostrada që lidh Varshavën me Berlinin.

Monumentet dhe debati për rishkrimin e historisë

Për t'u rikthyer sërish në terrenin shqiptar, vite më parë për në Kosovë shtegtoi "Gjergj Kastrioti", duke zënë vend në qendër të Prishtinës, çka i jep kuptim jetësisë kombëtare urbane atje. Me të njëjtin devocion është lartuar dhe statuja e Nënë Terezës në Prishtinë e Tiranë. Por dhe në komuna apo lokalitete ka buste dhe shtatore të standardit bashkëkohor, si në Zym të Hasit, statujat e Shtjefën Gjeçovit dhe Pjetër Bogdanit, mbi dy piedestale - në të njëjtën platformë, si për të shprehur vazhdimësinë historike nga njëri kolos te tjetri. Mirëpo gjithsekush, me ato që sheh e dëgjon, e kupton se ende monumentet janë pezull, të tjerë mund të ngrihen a mund të bien, mjafton që dikush të ketë një synim. Për më tepër tash që ia kemi hyrë diskutimit për tekstet e historisë, ku qeveritarët e lartë të shtetit turk kërkojnë që të ketë një trajtim, kinse bashkëkohor, të historisë së mesjetës, specifikisht që të shihet roli ndihm(emancip)ues i perandorisë otomane në vendet e sunduara prej saj, si Greqia, Shqipëria, Kosova etj (!?) Njëqind vitet e një shteti duhej të ishin të mjaftueshëm për të vënë pikat mbi "i" për atë që mund të quhet panteoni ynë kombëtar. Por duket se jemi ende të papërgatitur për këtë. Nuk dimë deri më tash nëse komisioni shtetëror qeveritar për kremtimet e 100-vjetorit ka në axhendë për të ngritur dhe disa buste të munguar burrash shteti. Pa folur për një problem alarmues: kur i shkrep në kokë një lideri apo grupimi politik, për të shënjuar dikë me bust, të nesërmen fillon e ngrihet piedestali, ashtu si kur bëhen bashkë tre këshilltarë bashkiakë "lobojnë" me shokët e tyre dhe menjëherë i hiqet emri që kishte rrugës, sheshit, shkollës, pallatit të kulturës, stadiumit dhe i vihet një emër tjetër "nesh". Kështu nis e krijohet një memorie historike e rrejshme. Nepotizmi nuk është vetëm në zyra, por dhe në emërtesa. Asnjë institucion kulturor, shkencor nuk pyetet për kësi punësh, kjo gjë më së shumti ngjan punë këshilltarësh e kryetarësh me mantel politik. Njëqind rrugë mund të gjendeshin në Tiranë për emrin e merituar të Ibrahim Rugovës, por pa qenë nevoja që për këtë të hiqej emri i "4 shkurtit" ('44), pasi lidhet me kujtesën e kryeqytetit në një nga netët më tragjike të tij dhe të krejt Luftës Nacionalçlirimtare. Ashtu siç për t'i vënë emrin e Dritan Hoxhës një rruge në Prishtinë, zor të jetë bërë ndokush "fli".

Është rasti për të menduar thellë dhe marrë vendimet e duhura. Pavarësia është kolona vërtebrore e historisë sonë. E kanë vënë në dukje të gjithë njohësit e Shqipërisë lajtmotivin shqiptar të lirisë, pavarësisë e qëndresës. Milan Gjilasi në kujtimet e tij shkruan se vitaliteti dhe vendosmëria e shqiptarëve, për të mbajtur pavarësinë e tyre, nuk ka të dytë në historinë njerëzore. Ky është dhe "monumenti" më i çmuar që ne duhet të ngremë në 100-vjetorin e Pavarësisë me buste dhe jo vetëm. Në këtë kontekst, teksa ne këtu heqim një bust e vëmë një tjetër, shoqata të ndryshme shqiptare në Itali janë mbledhur dhe kanë shpallur projektin për ngritjen e një përmendoreje të Ismail Qemalit atje. Ato kanë vendosur që statuja e themeluesit të shtetit shqiptar të ngrihet në sheshin "Tirana" në Milano. Kësaj nisme i janë bashkuar shumë qytetarë e biznesmenë që jetojnë e punojnë në Italinë e Veriut. Por dhe drejt Turqisë ka shtegtuar busti i një tjetër shqiptari të shquar. Në fillim të janarit, i shoqëruar nga një delegacion i Ministrisë së Kulturës, një bust prej bronzi i shkrimtarit, peshkopit dhe politikanit shqiptar, Fan Noli, për nder të 130-vjetorit të lindjes, është vendosur në sheshin "Republika" në Ibrik Tepe, qyteti i lindjes së tij. Siç shihet bustet e këtij viti jubilar nuk do të jenë vetëm brendapërbrenda. Pritet që të ketë shumë buste kësaj here dhe është e pritshme kjo pas një fushatë të rënies së busteve. Por a do të ngrihen ato, të duhurit, apo përsëri do të kemi buste për propagandë politike? Bustomani? E s'ke si të mos pyesësh: a mundet që një shoqëri e politizuar skajshëm dhe në punë të historisë, të ngre bustet e merituar? Në vendin dhe në kohën e duhur?...

RRËGJIMI KOMUNIST, ATEIST, MBYLLI KISHAT KATOLIKE!

Autorja e librit, synim të vetin kryesor ka atë se çfarë ndodhi gjatë asaj diktature të tmerrshme 50 vjeçare.

Libri: Dr. Nertila Haxhia Ljarja

"*Kisha Katolike në Shqipëri dhe Shteti Komunist 1944-1990*", Lezhë 2012.

Një reflektim

Ndër librat në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj, botuar gjer tani, për vuajtjet, persekutimin dhe qëndresën e Kishës katolike nën regjimin komunist është dhe "*Kisha Katolike në Shqipëri dhe Shteti Komunist 1944-1990*", i cili spikat me vlerën e tij.

Libri në fjalë, në krahasim me të tjerë botuar gjer tani në gjuhën shqipe mbi këtë temë, pjesa më e madhe e të cilëve janë kronika, dëshmi, përjetime, po dhe studime; është një punim studimor, i punuar me përkushtim, mjeshtri dhe shumë dashuri, nga studiuesja, Dr. Nertila Haxhia Ljarja. Autorja, edhe pse shtatin e saj të rritjes e ka hedhur gjatë sistemit komunist të më vonshëm, me pendën e saj të mprehtë dhe të kujdesshme, ka arritur të sjellë vërtetësisht dhe u ngjall emocion brezave të rinj, teksa kuptohet më mire, dhe më qartë, se cili qe fati i Kishës Katolike, gjatë diktaturës 50 vjeçare komuniste. Veprimet e sistemit komunist-ateist, ndaj një kishe e cila ndër shqiptarë vepron që plot dy mijë vjet, kishte shkuar aq lart, sa që dhuna, kishte marrë, madje përmasat e gjenocidit.

Libri, në çdo kapitull të vetin, duke përfshire edhe kohën mbretërisë se Ahmet Zogut, deri tek, përfundimi i regjimit komunist të Shtetit Shqiptar, ne vitet e 1990-të, zbërthen dhe dëshmon me fakte shkencore, funksionimin dhe organizimin e Kishës Katolike në Shqipëri, pozicionimin dhe qëndresën e saj gjatë kohës së Mbretërisë zogiste, si dhe torturimi qe u bë ndaj këtij institucioni, gjatë periudhës së një pushtetit të dhunshëm. Periudhë kjo e dhimbshme dhe e mundimshme për gjithë popullin shqiptar, të shkaktuar nga regjimi diktatorial i Enver Hoxhës. Libri në faqet e tij, përmban dhe Epilogun - ringjalljen e Kishës Katolike në Shqipëri, e cila pas viteve të 1990-të, kishte filluar riorganizimin e saj. Riorganizim që kurorëzohet me zgjedhjen e hierarkisë së lartë kishtare, në vitin 1993. Pjesë e rëndësishme e ringjalljes, në vitet e me vonshme, është dhe procedimi i procesit për 40 shërbëtoret e Hyjit, për ngritjen tyre, në Altarin e Shenjtë, për tu nderuar, si martirë në mbarë Kishën Katolike, në të katër skajet e botës.

Autorja e librit, synim të vetin kryesor ka atë se çfarë ndodhi gjatë asaj diktature të tmerrshme 50 vjeçare. Ajo përqendrohet në vitin 1945 apo edhe atë të 1967-ës, kur regjimi komunist i Enver Hoxhës nisi fushatën për mbylljen e kishave dhe të xhamive, prishjen e objekteve të kultit dhe, ku një nga qytetet që e ndjeu më tepër, ishte ai i Shkodrës, si qendra më e rëndësishme e kulturës dhe e historisë shqiptare edhe Kishës Katolike, si pjesë e pa



ndashme e saj.

Nga shtjellimi i hollësishëm i temës në fjalë, kuptohen qartë skenarët mjaft tronditës që ishin hartuar nga dora e Enverit. Në mesin e klerikëve më të shquar të kombit tonë, si: Imzot Vinçenc Prendushi, Imzot Frano Gjini, Dom Ndre Zadeja, Dom Nikollë Gazulli, Dom Lazër Shantoja, Atë Benardin Palaj, Atë Anton Harapi, Atë Gjon Shllaku dhe Atë Pjetër Meshkalla, edhe shumë të tjerëve, pas viteve 1945 dhe në vazhdim, u gjetën "armiq" të popullit edhe të Shtetit shqiptar; u përfytyruan organizatat terroriste të lidhura me shtetet imperialiste dhe të Vatikanit; u inskenua gjetja e armëve në kisha dhe altarë si edhe shumë pjella të tjera djallëzore, vetëm e vetëm që të gjendej një pretekst për ndërmarrjen e aksioneve ndëshkuese ndaj klerit katolik, i cili askurrë nuk u pajtua me një diktaturë komuniste e importuar në mes nesh, nga Sllavët e Lindjes, si armiq te përbetuar të popullit shqiptar në shekuj.

Sipas librit në fjalë, epilogu i gjithë këtyre inskenimeve, ishte se çfarë nuk u gjet e nuk u zbulua! Tronditës dhe i pashlyeshëm mbetet fakti se në mbështetje të kësaj imagjinate, në emër të kombit dhe të Drejtës së shtetit, u pushkatuan, u torturuan, u burgosën dhe u internuan, të gjithë ata që gjeja ishin fajtorë dhe ata që nuk u gjetën si fajtorë dhe armiq të popullit. Në pak kohë u mbyllën, seminare, shkolla, teatro, shtypshkronja, biblioteka, arkiva, të krijuara me shumë mund e djersë, prej qindra vitesh nga Kisha katolike. Dhe ajo çfarë ishte me e tmerrshme, eliminimi i fizik i klerikëve të shquar të kombit tonë, të cilët terë jetën kishin punuar, sipas motos, *Për Zot, Atme e Përparim*. Sipas, studiuesit të mirënjohur, të kësaj problematike, Pjetër Pepa, bilanci ishte rrëqethës: gjatë viteve 1944-1980 u mbytën në torturat çnjerëzore, u vranë, u burgosën, 7 ipeshkvij, 60 klerikë famullitarë, 30 etër françeskanë, 13 etër jezuitë, 10 seminaristë etj.

Klerikët e Kishës katolike, gjatë kësaj periudhe, përfaqësonin në shkallën më të lartë, kundërshtimin qytetar, qëndresën paqësore, guximin për të mos i tradhtuar idealet e veta, si njerëz të kushtuar Hyjit; për të mos i tradhtuar idealet kombëtare, pavarësisht çmimit tepër të lartë, jetës.

Prandaj, autorja e librit, me të drejtë, shpreh se, ata, kishin besimin e palëkundur që me vdekjen e tyre, thjesht po kurorëzonin një jetë në shërbim të kombit, me vetëdijen e plotë se vrasësit e tyre do të linin pas vetes turpin; ndërsa ata vetë, lavdinë e amshuar që i nderon ata dhe i bën nder Shqipërisë dhe shqiptarëve kudo që ndodhen.

Unë, shpreh bindjen, se, në këtë kuptim, pra, ata natyrshëm e ndriçojnë njësoj krenarinë e çdo shqiptari me dritën e tyre të mrekullueshme, pavarësisht besimit që kemi individualisht. Po ashtu, nuk ka pikë mëdyshjeje se vepra e tyre është po aq e shenjtë sa ajo martirëve të shumtë të njohur në mbarë Kishën katolike, si para Zotit, ashtu edhe para kombit shqiptar e para mbarë njerëzimit.

Dom Nikë Ukgjini



Kremtimi i Zojës së Shkodrës, 1912
Foto nga Edit Durham

PAGEANTRY AND POLITICS IN THE FESTIVAL OF OUR LADY OF SCUTARI


The strongest mountain tribes of Northern Albania have been faithful to the Latin Church through ages of persecution by Serb, Bulgar, and Ottoman. Remembering their wrongs, they hate most the Serb, Montenegrin, and Bulgar, who are all members of the Eastern Church. Their picturesque open-air processions on religious occasions are now like flaunts in the face of the Serb and his Scutari supporters

Photo M. Edith Durham

BIBLIOGRAFI E RRALL PËR POETIN NDRE MJEDA

Mentor Quku: "MJEDA-6", libri i dytë, Bibliografia e Mjedës, SHB-ILAR. Tiranë, 2012,

Libri i ri hapet me parathënien e Begzad Baliu me titull: Bibliografi e komentuar e studimeve për Ndre Mjedën. Libri që sapo ka dalë nga shtypi, paraqet një histori të detajuar, mjaft interesante të studimeve mbi një nga personalitetet më të spikatura të Rilindjes sonë Kombëtare, Ndre Mjedën. Janë gjithsejtë 413 autorë, kryesisht studiues, shkrimtarë, gazetarë, që paraqiten me 1175 zëra bibliografikë, të cilët japin njohuri mbi jetën dhe veprën e Ndre Mjedës, të cilët ndriçojnë plane të ndryshme të figurës së shquar të këtij rilindësi. Në krye të toplistës së studiuesve më të spikatur të Mjedës, qëndron shkrimtari dhe studiuesi i spikatur, Mark Gurakuqi (1922-1970), i cili, nga viti 1956 e deri sa vdiq, iu kushtua plotësisht kërkimeve, studimeve dhe botimeve mbi poetin dhe gjuhëtarin e madh. Jehona e veprimtarisë shkencore të tij do të vazhdojë edhe pas vdekjes, duke iu botuar veprat edhe deri në ditët e sotme. Plejada prej dhjetë studiuesve më të përkushtuar dhe më prodhimtarë në fushë të studimeve mjedologjike, plotësohet me studiuesit dhe shkencëtarët e shquar: Jup Kastrati, Dhimitër Shuteriqi, Rexhep Qosja, Injac Zamputi, Vehbi Bala, Rinush Idrizi, Tomor Osmani, Milazim Krasniqi, Mark Ndoja dhe Llazar Siliqi. Për Mjedën kanë shkruar edhe personalitete të tjera të shquara si Jolanda Kodra, Mark Krasniqi, Henrik Lacaj, Dom Nikoll Marreku, Jakov Mile, Rajko Nahtigal, Filip Ndocaj, Holger Pedersen, Arshi Pipa, Fadil Podgorica, Ilo Mitko Qafëzezi, Selman Riza, Paul Sibertz, Engjëll Sedaj, Atë Aleksandër Sirdani, Sterjo Spase, Gjush Sheldija, Atë Viktor Volaj, Atë Carlo Villavicenzo, Dom Ndre Zadeja,



Mentor Quku para shtëpisë se Mjedës në Kukël

Atë Gjon Shllaku, Ismail Kadare, Dritëro Agolli, Idriz Ajeti, Ali Aliu, Eqrem Çabej, Anton Cetta, Palokë Dakaj, Bedri Dedja, Mahir Domi, Qemal Draçini, Skënder Drini, Atë Antonin Fishta, Atë Gjergj Fishta, Dom Nikollë Gazulli, Giuseppe Gradilone, Padër Daniel Gjeçaj, Enver Gjergjeku, Ndoc Gjetja, Dom Nikoll Gjini, Hamid Gjylbegu, Nexhat Hakiu, Atë Mark Harapi, Gaspër Mërturi Jakova, Willy Kamsi.

Duke parë grafikun e studimeve mbi Mjedën, të cilin na e pasqyron më së miri bibliografia e sapo botuar, mësojmë shumë gjëra mbi ecurinë e këtyre studimeve, mbi ndjeshmërinë që ka pasur emri dhe vepra e Mjedës në rrethet kulturore, letrare apo ato zyrtare të kohës, për vlerësimet, sulmet, paragjykimet ndaj figurës së tij. Për herë të parë emri i Mjedës gjeti jehonë në shtyp, sapo u kthye në Shkodër, në pranverë të vitit 1899, me argumentin kryesor, atë të debateve që pati me anëtarët e shoqërisë *Bashkimi* për problemin e alfabetit të gjuhës shqipe. Më tej ai do jetë prezent në tekstet shkollore, në leksionet e letërsisë, në kronikën e ngjarjeve të ditës, gjithnjë sa më në hije, gjithnjë pa pretendime, në ndryshim nga shumë bashkëkohës të tij. Mjeda ndoqi tërë jetën parimin e modestisë dhe të përkores: "*Ma mirë me qenë se me u dukë*". Do të ketë një kulm në jehonën që pati në shtyp, në vitet 1936-1938, periudhë që përkon me momentin që shuhet një nga krojet më të pastra të poezisë shqipe, Ndre Mjeda. Kulmi I dytë do të jetë ai i viteve 1942-43, koha kur shpërthyen debate të forta rreth figurës së poetit, lidhur me problemin e Kongresit të Manastirit, si edhe atë hierarkisë së poezisë shqipe. Me këtë rast hodhën shumë baltë mbi emrin e tij, gjë e cila pati efekt të kundërt, bëri të rritet interesimi për figurën e tij, si edhe të rilexohej vepra e tij. Nga i gjithë ky debat doli edhe më e ndritur figura e tij e shquar. Pastaj vjen periudha e instalimit të diktaturës në Shqipëri, që shoqërohet me një heshtje dhe më vonë një pranim me rezerva i veprës së dom Ndre Mjedës. Në vitin 1966, me rastin e jubileut të 100-vjetorit të lindjes pati një bum studimesh, botimesh për Mjedën. U duk sikur do të kishte një hov në studimet mbi poetin, mirëpo përsëri ra intensiteti i botimeve mbi Mjedën, për të pasur një farë ringritje në vitet '80, për të rënë në fund fare gjatë viteve të tranzicionit '90. Kjo përkon me humbjen edhe të eshtrave të poetit që deri atëherë ishin në ruajtje në zyrën e varrimeve të qytetit të Shkodrës. Ishte kohë tranzicioni dhe eshtrat e tij u varrosën pa kujdes, në Rrmaj, nja 20 metra, në të majtë të Kishës së Varreve, mbi të cilin u vendosën, si shej i përkohshëm, disa gurë të mëdhenj. Njerëz që punuan në këto varre, tregojnë se ndofta dikush ndërtoi një varr të ri mbi atë të Mjedës.

Me fillimin e shekullit XXI, për një dekadë pati një fluks të dukshëm të studimeve mbi jetën dhe veprën e Mjedës. Kemi një katërfishim të intensitetit të studimeve në krahasim me mesataren e shekullit që shkoi. Kemi sesione speciale për Mjedën, po ashtu edhe botime speciale. Një brez i ri studiuesish i dhanë impulse shkencës së re të Mjedologjisë, ku dallohen Milazim Krasniqi, Ahmet Isaku, Kolec Çefa, Begzad Baliu, Gazmend Krasniqi, Vjollca Osja, Flamur Maloku, Marjana Ymeri, Shaban Sinani, Tefë Topalli, Adil Olluri, Evalda Manovi, Alfred Capaliku, Stefan Capaliku, Tonin Çobani, Ismet Durmaku, Mehmet Elezi, Arjeta Ferlushkaj, Tahir Foniqi, Fatbardha Hoxha, Ilir Kanini, me në krye patriarkët, Rexhep Qosja, Emin Kabashi, Italo Kostante Fortuno, etj. Në 2009 u zhvillua një sesion shkencor kushtuar Mjedës në Prishtinë nga Alb-Shkenca, I cili u botua plotësisht, pati edhe një numër special reviste shkencore kushtuar Mjedës "*Malësia, nr.3*" meritë kryesore e kryeredaktorit të saj, Nikë Gashaj. Një nxitje dha në këtë hov, komuniteti shqiptaro-amerikan me organizimet e tij, seminari "*Shkodra në Shekuj*" i dha një shtysë studimeve mbi Mjedën, ato u botuan. Në 2007 u mbajt në Bibliotekën *Marin Barleti* një sesion shkencor kushtuar Mjedës, por që nuk u botua asnjëherë. Shtysa filloi me ardhjen e Dom Nikë Ukgjinit në krye të famullisë së Kuklit. U xhirua një film kushtuar Mjedës. Shumë studiues të rinj u angazhuan me tema diploma dhe master, nga vepra e Mjedës. Vëllimi i ri lexohet si një histori intriguese me kohëzgjatje më shumë se një shekull, me protagonist kryesor një figurë të ndritur, por edhe me shumë personazhe të tjera shumë interesante të historisë kombëtare, gjatë shekullit që shkoi, por me pritmëri edhe në shekujt që vijnë.

AT GJERGJ FISHTA - FRYMZIM PËR BREZAT E RINJ
Zbulimi i Bustit "Atë Gjergj Fishta", në Jagodë - Klinë



Më 12 Prill, 2012, në fshatin Jagodë të Klinës – Kosovë, në oborrin e Shkollës Fillore, të fshatit Jagodë, u përurua busti i Atë Gjergj Fishtës. Ky manifestim u organizua nga famullitari i fshatit dhe iniciatori i kësaj vepre, Don Robet Jakaj dhe Kryetarit të Komunës së Klinës, z. Sokol Bashota. Në ceremoninë e zbulimit të Bustit të Atë Gjergj Fishtës, morën pjesë personalitete të shquara, nga Qeveria e Kosovës, Administratura Apostolike e Kosovës, Bashkësia Islame e Klinës, studiues, arsimtar, nxënës e qytetarë nga Jagoda dhe rrethinat, si dhe mysafir nga Lezha - Shqipëria dhe mërgimtar nga diaspora.

Kryetar i Klinës, **Sokol Bashota**, nder të tjera u shpreh se, është nder qe një shkollë në Komunën e Klinës te ketë bustin e këtij kolosi të letrave shqipe, i cili tërë jetën ia kushtoj përhapjes së kulturës dhe gjuhës shqipe në popullin shqiptar. Atë Gjergj Fishta, në fushën diplomatike, gjithashtu dha një kontribut të çmuar, për njohjen e Shqipërisë si shtet ne vete.

Mëkëmbësi i Përgjithshëm i Administraturës Apostolike të Kosovës, **Dr. Don Lush Gjergji**, përkujtoi se, figura e Gjergj Fishtës rrezaton, në vetë atdhedashurinë, filozofinë, letërsinë dhe humanizmin e pa shoq. Duke e vlerësuar lart veprën e Fishtës, Don Lushi, lëshoj kritika për çarqet e caktuar të cilët po mundohen t'i ulin vlerat e njerëzve të mëdhenj shqiptarë. “Sot, nuk jemi më, të sulmuar e të penguar nga të tjerët, por nga ne vetë, kur disa prej nesh i vejnë në dyshim, disa nga personaliteteve të mëdha të kombit tonë si: Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, Nënë Tereza, Gjergj Fishta e tjerë. Ky veprim është një vetëvrasje historike, shpirtërore e kulturore, është një përdhosje e historisë si dhe një kërcenim i tashmes dhe së ardhmes sonë”, është shprehur Don Lush Gjergji.

Viktor Tusha, kryebashkiaku i Lezhës në Shqipëri, tha: “Ardhja ime sot është e veçantë, pasi që vij bashkë me një bashkëqytetar që quhet Atë Gjergj Fishta, i cili tashmë edhe pa monumente është i madh. Por, me këtë sot i bëjmë nder atij, siç na bëri ai neve, vite të tëra duke kontribuar për lirin e Shqipërisë”. Sipas Tushjat, Atë Gjergj Fishta ishte përkrahës i flaktë i shqiptarizmës, të cilën e gdhendi me pendën e tij, duke e vënë në analët botërore.



Ndërkaq, Zëvendës Ministri i Drejtësisë, z. **Daut Xhemajli**, ka vlerësuar Fishtën, si personalitet profetik të kulturës shqiptare i cili më krijimtarinë e tij ishte i gjithanshëm. Te pranishëm në ketë kremtim ishin, artisti i njohur nga Shqipëria, **Reshat Arbana**, me recitimet e vargjeve te Fishtës, autori i vepres, skulptori, **Gani Bajraktari, prof. Anton Nikë Berisha** si dhe financuesit e kësaj vepre vëllezërit, **Pal e Pren Nikollaj** mërgimtar në SHBA

VITRINË LIBRI



NERTILA HAXHIA LJARJA
Kisha Katolike dhe Shteti Komunist në Shqipëri


Universiteti Shkodrës
Gjergj Fishta, Lezhë 2012



GJON BALLABANI

Në Shërbim Të Jetës

Drita, Prishtinë, 2011



MENTOR QUKU

Mjeda 6

Ilar - Tiranë 2012

KUMBONA E SË DIELËS
revistë fetaro-kulturore dymujore
e Kryedioqezës Metropolitane Shkodër-Pult
Tirazhi: 1000 kopje
Çmimi: 100 lekë (Evropë: 2 Euro)
Parapagimi vjetor 600 lekë
(Evropë: 12 Euro)
e-mail: n_ukgjini@yahoo.it
Web page: www.kishakatolikeshkoder.com
Adresa: Arqipeshkvia Shkodër,
Sheshi "Gjon Pali II"
Shtypur në Entin Botues "Gjergj Fishta" - Lezhë

KUMBONA E SË DIELLËS
Viti XXVII, nr. 3/4 (438-439) Mars - Prill 2012